



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

I DËGJIMIT PUBLIK NË KOMISIONIN PËR ZHVILLIM EKONOMIK, ...
MBAJTUR MË 28. 3. 2018

SA JAVNE RASPRAVE U KOMISIJI ZA EKONOMSKI RAZVOJ,...
ODRŽANA 28. 03. 2018. GODINE

MARS / MART
2018

Dëgjim publik për Projektligjin për miniera dhe minerale

KRYETARJA: Përshëndetje të gjithëve,
Të nderuar kolegë dhe kolege deputetë,
Të nderuar të gjithë ju të ftuar që keni ardhur sot në këtë dëgjim publik,
Kërkoj falje nëse s'më kujtohen emrat e të gjithëve,
Kryetari i Drenasit Lladrovci,
Kryetari i komunës së Obiliqit, zoti Gashi,
Kryetari i komunës së Hanit të Elezit, zoti Suma,
Komisioni i Pavarur për Miniera e Minerale,
Fakulteti i Gjeoshkencave, dekani zoti Peci,
Shoqëritë civile,
Gjithë përfaqësuesit e kompanive që merren me operime minierare,
Ju të pranishëm,
Zoti Rexha, zoti Zeqiri,
Gjithë të tjerë,
Ju falënderoj shumë për kohën që keni gjet me ardhur sot me ne këtu.
Sot kemi dëgjim publik sipas rregullave që janë të përcaktuara në Rregulloren e Punës së Kuvendit të Kosovës.

Ne sot ju kemi ftua të bashkëbisedojmë me juve ose thënë më shkurt me ju dëgjua juve rreth Draft-ligjit të ri për miniera dhe minerale.

Njerëzit i duan ndryshimet, po shpesh ju druhen ndryshimeve.

Ne si deputetë, si anëtarë të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë Tregti Industri dhe Zhvillim Rajonal masë një pune bukur të gjatë dhe të ngjeshur që kemi bërë për monitorimin e zbatimit të Ligjit për miniera dhe minerale në mandatin e kaluar krejt në fund të mandatit ligji ka qenë i gatshëm, mirëpo u shpërbë Kuvendi dhe duhet sipas procedurave me fillua prej zeros.

Gjatë monitorimit të Ligjit për miniera dhe minerale në bashkëbisedim me ju me kryetar komunash, me ndërmarrje publike, me operatorë privat të operimeve minerare kemi vërejt se ligji ka mangësi zbrastirë prandaj e kemi pasur një arsye të fortë që t'i hyjmë fillimisht një plotësim ndryshimi por duke i pasur edhe ndryshimet janë substanciale kemi ardhur në përfundim bashkërisht me Komisionin Parlamentar, me kolegët e mijë deputetë duhet të jetë krejtësisht një ligj i ri i cili zbatimin e tij do ta kishte shumë më të lehtë për ligj zbatuesit siç janë institucionet dhe operatorët privat sepse e para është zbatimi më i lehtë, ata do të kenë punë me një dokument të vetëm përderisa më herët është dashtë me i përdorë 2-3 dokumente varësisht sa

ka pësua plotësime dhe ndryshime Ligji i minierave që nga hyrja e tij në fuqi në vitin 2008 si pjesë e pakos së Ahtisarit.

Konsideroj që ky draft që e keni ju para jush sigurisht që e keni marrë administrata e Kuvendit ka qenë e obliguar bashkë me ftesën t'ua dërgoj edhe draft-ligjin.

Ka ndryshime që e lehtësojnë punën e të bërit biznes që e lehtësojnë zhvillimin e sektorit minerarë që është risi në këtë ligj edhe ta taniema 20% do të takoj komunave për zhvillimin e komunitetit sikurse që është kjo dispozitë ligjore edhe te Ligji për Trepçën po edhe te Ligji për Obiliqin do ta bëjmë dispozitë obligative ligjore për të gjithë operuesit minerarë nëpër ato komuna apo komunitete ku veprojnë dhe operojnë. Kjo është e para përfitimi i komunitetit.

E dyta, që është shumë e rëndësishme në momentin kur keni marrë licencë për hulumtim dhe shfrytëzim është dashtë ta depononi një shumë të parave me një kriter Tri A plus që nuk kemi has as në rajon që ka qenë pengesë për operatorët fillimisht është dashtë të hyjë në minus dhe pastaj të fillojnë afarizmin e tyre edhe këtë dispozitë ligji e adreson në favor të operatorëve.

Një tjetër çështje që është shumë me rëndësi që do ta eliminonte burokracinë administrative është e paraparë në ligj që të jetë një zyrë në një vend e ashtuquajtur huan stop shop që operatorët nuk do të kenë më nevojë të bredhin nëpër institucione të ndryshme për të marrë leje dhe licenca të ndryshme po zyrtarët të cilët do të punojnë në atë zyrë do t'i kryejnë të gjitha obligimet e nevojshme sa herë që kanë nevojë operatorët.

Tjetër, ne gjatë monitorimit të zbatimit të ligjit kemi pasur diskutime dhe kërkesa nga operatorët për shkak të distancave që kanë qenë shpesh pengesë për veprimtarinë e operatorëve në sektorin minerarë.

Jemi mundua me i analizua mirë edhe ato distanca bie fjala si te ndërmarrjet private edhe te publike, bie fjala ju e dini shumë mirë vitin e kaluar kemi qenë para kolapsit energjetik për shkak se KEK-u nuk ka pasur mundësi të zgjerohet me tutje ka qenë pengesë ligjore dhe distanca që janë paraparë me ligj, ndërkohë që tani me këtë ligj të ri ne të kërkojmë që varësisht nga studimet e gjeomekanikës distancat mund të largohen ose mund të afrohen që të mos jenë strikte dhe mos të vlejnjë për të gjitha rastet.

Tjetër ndryshim pengesë ka qenë edhe sipërfaqja e licencave dhe lejeve që i ka lëshua Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, ndërkohë që nuk ka qenë e përputhshme me sipërfaqen të cilën e ka lëshua Agjencioni i Pyjeve.

Ne me këtë ligj e kemi rregullua këtë çështje dhe është ligj bazik i cili mbizotëron të gjitha ligjet tjera, po si do qoftë ne si deputetë do të kemi mundësinë edhe rastin në momentin kur të vije në Kuvend sepse është strategji legjislative Ligji për pyjet dhe do ta kem vëmendjen që në

momentin kur të amendamentohet ai ligj të jetë në përputhje me Ligjin për miniera dhe minerale kjo çështja e distancave e shumë çështje tjera që për momentin nuk po më kujtohen po ju sigurisht e keni analizua dhe e keni pa.

Dëgjimi publik na jep neve një mundësi me ju dëgjua edhe juve edhe pastaj edhe për çështje tjera që ne nuk i kemi prek apo nuk i përmenda tani, sot e keni rastin ju të na thoni dhe të na mbushni mendjen para deputetëve se i duhen këto ndryshime ligjit, natyrisht se ndryshimet, plotësimet po edhe ligjet e reja bëhen gjithmonë në të mirë e sektorit dhe të qytetarëve.

Në bazë të një statistike ose një hulumtimi një analize që e ka bërë Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale 16 mijë punëtorë janë të kyçur në sektorin minierarë çka do të thotë se me këtë ligj që do të rregullohet ambienti i të bërit biznes ka mundësi që të rritet numri i punëtorëve edhe diku afër 50 mijë vende të reja të punës do të hapen në këtë sektor.

Ne jemi përcaktua si shtet për ekonomi të lirë të tregut dhe kemi obligim që të ofrojmë infrastrukturë ligjore që e ndihmon këtë drejtim dhe duhet ta dimë të gjithë se shteti më nuk hap vende pune po krijon mundësi për hapje të vendeve të reja të punës.

Faleminderit, që më dëgjuat,

Unë tani pa dashtë me ja u marrë kohë e vlefshme të juaj dhe tonën ju të pranishëm duke besua se e keni analizua draftin edhe një herë do të ju kaloj fjalën juve, pastaj nëse keni pyetje specifike për deputetë, sot ne jemi për me ju dëgjua po në qoftë se ka dikush edhe prej deputetëve me shtua diçka para se me hap debatin.

A e donë dikush fjalën prej deputetëve, fjalën e ka kërkuar Hykmete Bajrami.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryetare!

Të nderuar kryetarë të komunave,

Kryetar të Bordit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerare,

Të gjithë të pranishëm,

Është mirë që po takohemi rreth kësaj tryeze për të diskutua një nga ligjet më të rëndësishme.

Tash disa jemi më . rreth industrisë së madhe në Kosovë, do të thosha një nga sektorët tepër të rëndësishëm siç është industria e gurthyesve dhe industrisë së eksploatimit të mineraleve e disa të tjerë ndoshta jemi pak më të ndjeshëm kur është çështja e mbrojtjes së ambientit.

Në fakt nuk e di nëse ka prezent rreth kësaj tryeze edhe nga Ministria e Ambientit gjithashtu Agjencioni për Mbrojtjen e Ambientit po do të ishte me interes që në fakt ligjin ta shikoni dhe ta komentoni edhe ata.

Ligji është punua siç e thatë kryetare edhe në mandatin e kaluar, andaj ne si deputet gjatë leximit të parë nuk është që jemi involvuar shumë me qenë se ka punua Komisioni dhe ju personalisht në mandatin e kaluar për me qenë se kishim këtë dëgjim publik kemi pa ligjin dhe kemi disa vërejtje që sigurisht nuk janë të njëjta me ata të cilët janë drejtpërdrejtë të involvuar në sektorin e gurthyesve dhe në sektorin e eksploatimit të minierave dhe mineraleve.

E para, arsyeshmëria për plotësim dhe ndryshim të ligjit nuk besojmë që është dokumentua të paktën edhe të dhënat edhe raportet e Komisionit të Pavarur të Minierave dhe të Mineraleve nuk theksojnë që ka një mosfunksionim për shkak të ligjit ekzistues i cili është në fuqi.

E dyta, me versionin aktual të cilin po e diskutojmë dhe e kemi para nesh sigurisht që janë bë disa ndryshime të cilat ndoshta ndikojnë pozitivisht për operatorët ekonomik të cilët janë në këtë industri por ndikojnë negativisht në mbrojtjen e mjedisit.

Me vetë faktin që janë krijuar lehtësira të tilla të cilat përgjysmojnë distancat nga lumenjtë unë besoj që kjo është një gjë e papranueshme edhe unë personalisht do të paraqes amendamente për t'i kthye distancat e mëparshme e nëse është e nevojshme pasi të konsultohem edhe me ekspertë të mbrojtjes së ambientit për t'i rritë këto distanca në favor të mbrojtjes së ambientit.

Do të llojoj shumë edhe me deputetët të tjerë që në fakt amendamente të tilla në qoftë se nuk përkrahen nga Komisioni të kalojnë.

Ju e dini ne jemi dëshmitarë të gjithë që jetojmë në Republikën e Kosovës që shtretërit e lumenjve janë shkatërruar tërësisht për shkak të operatorëve ekonomik që janë në industrinë e gurthyesve që janë komplet të papërgjegjshëm.

Ndërkohë që u përmend largimi i garancionit bankar A+ nga KPMM-ja në rastin kur merret licenca.

Ju e dini që shpeshherë në emër të licencës për eksplorim janë eksploatime të shumta, janë shkatërrua shtretër të lumenjve edhe ky garancion bankar i ka mundësua KPMM-së që në fakt ta ekzekutoj garancionin në qoftë se nuk është krye rehabilitimi në bazë të kontratës fillestare që ka mund ta ketë një operator ekonomik që ka marrë licencë për eksplorim por nuk ka pasur licencë më vonë ndoshta për eksploatim.

Unë po besoj që garancioni bankar duhet të kthehet gjithsesi, industria minerare gjithashtu edhe ajo e gurthyesve është industri shumë profitabile dhe aty nuk mund të futet gjithkush pa kapital fillestar.

Kur hyn në një industri e cila është profitabile dhe ka treg të siguritë natyrisht që duhesh me bë investime që i paraprinë atij biznesi. Kështu që unë mendoj që kjo nuk është mirë, nganjëherë favoret që donë me i bë sektorët privat edhe në emër të gjithë atyre të punësuarve që janë e tjera, në qoftë se janë në dëm të shkatërrimit të mjedisit atëherë racionalja ekonomike na qon që ne duhet ta mbrojmë mjedisin.

E në anën tjetër ajo çka ne tentojmë tash e tutje me e fut si nen tek të gjitha institucionet e pavarura që i raportojnë Kuvendit është që nëse dy vite radhazi nuk votohet raporti nga Kuvendi i Kosovës me automatizëm bordi të shkarkohet.

Kemi pasur raste sigurisht që nuk keni pas, nuk më kujtohet që ju si institucion keni pasur najë rast kur raporti i juaj nuk është votua të paktën mua nuk më kujtohet nuk kam informacione.

Por konsiderojmë që kjo duhet të rregullohet me ligjet respektive të institucioneve. Në qoftë se dy vjet radhazi ne bordi domethënë në këtë rast institucionit të pavarur nuk i votohet raporti nga Kuvendi atëherë bordi me automatizëm duhet të shkarkohet.

Do të fusim edhe klauzola të tjera besoj që do e pasurojmë ligjin me nene që kërkojnë depolitizim të bordeve është tepër e nevojshme që të kemi institucione të depolitizume, besoj se kur është në ligj kjo ju ndihmon edhe partive politike cilat do qofshin ato në Qeveri në mënyrë që të marrin njerëz profesionistë dhe të mos jenë nën presionin e militantëve të tyre partiak kur ka pozita të lira në institucione të tilla dhe gjithashtu besojmë që duhet të pasurohen edhe kriteret e profesionalizimit me rastin e rekrutimit të bordit.

A mendojmë që ka edhe dispozita të tjera, shpeshherë janë lënë gjëra ndoshta të tepërta në diskrecion të bordit ku normalisht këto përcillen mandej edhe me përgjegjësi po këto janë vërejtjet e mia fillestare sa i përket draftit të cilin po e shpjegojmë.

Në fakt dëgjimet publike zakonisht anëtarët e Komisionit nuk është që japin vërejtje të tilla.

Unë me qenë se jemi në këtë setap edhe po bisedojmë sot e pata me shumë interes të ju tregoj që këtu do të jenë amendamentet në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe do të llobojmë fortë që këto në fakt të kalojnë. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, deputete!

Besoj që nuk ke nevojë me bë amendament në emër të Grupit Parlamentar sepse je pjesë e këtij Komisioni dhe klima natyra e punës së Komisionit është e tillë që këtu nuk kemi shumë ngjyrimë politike sepse merremi vesh që në Komision sa i përket shqetësimit tuaj për ambientin natyrisht se të gjithë jemi të shqetësuar por po ua rikujtoj sepse e kam analizua me shumë vëmendje Ligji për mbrojtjen e mjedisit i ka të parapara këto distanca që ne i kemi harmonizua me atë ligj.

Ndërkohë që ligji në fuqi që është deri tani i ka parapa distancat më të larta se sa Ligji për mbrojtjen e mjedisit.

Prandaj, i kemi ik edhe kolezionit të atij ligji, besoj që ndoshta dikush prej pjesëmarrësve kish me thanë këtë ose ka me artikulua më mirë se sa që po e them unë.

Natyrisht që drafti është i punuar s' domethënë gjithmonë ka hapësirë për më mirë po është i punuar në atë mënyrë që të ketë balanca dhe të jetë në raport miqësorë edhe me ambientin, ne kemi pasur parasysh edhe këtë. Besoj që ne do të ulemi si grup punues edhe si Komision pas këtij dëgjimi publik menjëherë t'i shohim të gjitha ato vërejtje sugjerime që do të na japin të tjerët.

Tjetër, është e vërtetë se është profitabile si sektor, mirëpo dëshiroj me ja u përkujtua se është bukë me shumë kore profitabiliteti nga ky sektor është sektori që është më i vështirë me punua dhe më i rrezikshëm sa i përket sigurisë së punëtorëve në punë.

A e donë fjalën dikush prej deputetëve apo është lajmërua shoqëria civile, INDEP, fjala është e juaja zoti Abazi.

DARDAN ABAZI: Faleminderit!

Unë mendoj që ka një arsye pse quhet dëgjim publik në mënyrë që publiku të flasë e institucionet të dëgjojnë edhe mendoj që është shumë e rëndësishme me u rritë komunikimi edhe në mes të komunave dhe institucioneve këtu që janë edhe në mes të deputetëve në mënyrë që së paku këto dëgjime të cilat janë publike të na dedikohen më shumë neve edhe ulja në tavolinë tregon shumë çka në këtë drejtim.

Jam Dardan Abazi, nga Instituti INDP dua të përshëndes këtë dëgjim publik, mbajtjen e këtij.

Konsiderojmë që Ligji për minierat dhe mineralet rregullon një nga sektorët më të mëdhenj dhe më së shumti potencial në Kosovë, rrjedhimisht është një nga ligjet themeltare që prek jo vetëm sektorit të tillë por edhe shumë fusha të tjera, zhvillimin ekonomik, mjedisin, shëndetin publik e të tjera.

Në fjalën e juaj ju thatë që ka pasur tendencë për një balancim në mes të zhvillimit ekonomik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Konsiderojmë që në këtë kuptim realiteti nuk është i balancuar për shkak se për shembull në njërin anën KPMM-ja raporton që në pesë vitet e fundit ka pasur dyfishim të licencave të hulumtimit dhe gati dyfishim të licencave të shfrytëzimit. E në anën tjetër mbi 1000 hektarë tokë të lumenjve janë të kontaminuar dhe siç raportohet në raporte të ndryshme si për shembull të

Organizatës Qohu aty thuhet që ka pasur raste kur edhe rrjedhja e lumenjve është ndryshuar për shkak të aktiviteteve minerare.

Në këtë kuptim në nenin 14, ky Komision ka hequr tërësisht distancën nga lumenjtë e cila ka qenë prej 150 metrash dhe konsiderojmë që kjo është një hap prapa dhe e kundërshtojmë si të tillë.

Vlerësojmë që distanca prej 150 metrash ose edhe më e gjatë nga lumenjtë duhet të futet në nenin 14 të këtij ligji si një përgjigje ndaj një realiteti të hidhur që është në terren e i cili tregon për degradim të përditshëm të lumenjve e në anën tjetër industria po lulëzon si e tillë.

Në të njëjtën kohë menduam që pika 2 e nenit 14, duhet hequr tërësisht pasi nuk mund të jetë në diskrecion të KPMM-së që t'i shmanget sa herë që ta vlerësoj ajo distancave apo kufizimit nga distancat.

Në qoftë se mbetet pika 2 që KPMM pas një kërkesë nga operatori mund t'i shmanget nenit 14, atëherë edhe vetë kuptimi i kufizimit të distancave i humbet për shkak se në atë rast gjithçka mbetet në ... të KPMM-së.

Sa i përket nenit 17 të Once Sop Shop modeli që është paraparë me një nen dhe tri pika nuk është një hapësirë në të cilën institucionet të ndryshme do të punonin që të përfundojnë procedurat e një vendi të themi edhe përfaqësues të komunave edhe përfaqësues të agjencionit të Pyjeve dhe të Ministrisë së Mjedisit e të tjera.

Po është një zyre në kuadër të KPMM-së e cila përcjell kërkesat për pëlqimin në emër të ndërmarrjeve që kanë aplikuar tek institucionet e tjera relevante.

Madje pika 2 e këtij neni thotë: “Nëse institucionet relevante nuk përgjigjen brenda një afati të paraparë me ligjet përkatëse atëherë KPMM-ja obligohet të marrë vendim në përputhje me strategjinë minerare.

Mendoj që ky është një lloj shantazhi ndaj institucioneve tjera dhe nuk përbënë modelin që do të duhej ta kishte një Once Sop Shop i cili do të duhej të përbëhej nga këto institucione dhe të cilat së bashku do të punonin që në një vend të ofronin dokumente të nevojshme.

Nuk mundet që të afatizohen institucione të tjera e të shantazhohen në dhënie të licencës edhe kur ajo mund t'i kundërshtoj ose mund të bie në kundërshtim me kërkesat që këto institucione kanë.

Tek neni 20, propozojmë që regjistri i licencave jo vetëm t'i ofrohet publikut bazuar në Ligjin në qasjen e dokumenteve publike por publikimi i këtij regjistri të jetë automatik dhe të jetë i qasshëm 24 orë nga publiku.

Kundërshtojmë zgjerimin e kohëzgjatjes së licencës së shfrytëzimit të mineraleve energjetike nga tri vjet në 40 vite si të panevojshëm dhe të pa arsyetuar.

Jemi vendi i vetëm evropian që po promovojmë përdorimin e linjitit dhe po ndalim transformimin e pa alternativ të sektorit energjetikë.

Tek përzgjedhja e bordit duhet të rritet kriteri profesional nga 5 vite në 10 vite përvojë.

Si dhe tek neni 54 i shkarkimit të anëtarëve të bordit pikat 4 dhe 5 të hiqen. Nuk munden që vendimet e Kuvendit të Kosovës të hidhen poshtë nga konfliktet administrative dhe vetëm Gjykata Kushtetuese është e autorizuar të kontestoj vendimet e Kuvendit.

Ky farë pezullimi me pagesë i shtuar në këtë nen mendojmë përzierjen e komentencat e Kuvendit dhe është jo kushtetues.

Përgjithësisht këto janë ato që i kemi si më të mëdha e të tjerat do t'i dërgojmë me shkrim. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, Dardan!

Veç për hir të sqarimit të këtij auditoriumi unë do ta falënderoj shumë edhe një herë INDEP-in i cili e ka organizua një trykë gjatë draftimit të këtij ligji. Ndoshta tash e ka pa që duhet me i dhënë këto vërejtje po atëherë nuk i keni dhënë Dardan këto vërejtje me përjashtim të çështjeve ambientale që e dimë pse i jepni ato vërejtje edhe kur thua realiteti s'është i balancuar duhet t'ia rikujtoj këtij auditoriumi po edhe juve se gjithmonë sfidë në raportin e punës një vjeçare të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale janë edhe operimet ilegale. Për realitetin që është në kundërshtim me këto çka parashihet në ligj kjo është sfida.

Prandaj, ne jemi mundua që me këtë draft edhe këtë sfidë me e zbutë ose me adresua që të ketë sa më pakë operime ilegale e sidomos duhet me bë dallimin mes asaj.

E kuptoj se kur nuk mund të jesh shumë i familjarizuar ...nuk e kam fjalën për ty Dardan po nuk ka gurthyes afër lumenjve, afër lumenjve janë aluvionet, deluvionet të shkriфта por gurthyes nuk janë. Prandaj, duhet të bëjmë një farë dallimi.

Sidomos operimet ilegale i kemi për gjatë shtrirjes së lumenjve ku merret minerari i quajtur aluvion, deluvion, rërës dhe zhavorrit aty tërhiqen më me lehtësi edhe është bukur problem me i

ndërpre pa u angazhua të gjitha institucionet e Kosovës jo vetëm Komisioni i Minierave dhe Mineraleve apo edhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik por duhet komplet institucionet me u angazhua për me e ndërpre atë degradim të mëtutjeshëm të lumenjve dhe të ambientit.

Kush e donë fjalën, dikush tjetër. Fjalën e ka kërkuar kryetari i Komunës së Obiliqit zoti Xhafer Gashi, fjala është e juaja.

XHAFER GASHI: E nderuar kryetare e Komisionit,

Të nderuar deputetë,

Kryetarë,

Përfaqësues të MZHE-së,

KPMM-së, Trepçës,

Shoqëritë civile,

Në shkurt asociacioni i komunave ka organizua një punëtori ku kemi marrë pjesë katër komuna në këtë rast komuna e Obiliqit, Drenasit, e Mitrovicës dhe komuna e Elez Hanit.

E kemi rishikua me kujdes projektligjin dhe gjatë leximit të projektligjit ne kemi nxjerr disa propozime apo amendamente që i kemi drejtua me shkrim te ky i nderuara kryetare.

Për shembull te amendamenti numër 5, pika 5.2 KPMM-ja lëshon licencën pas dhënies së pëlqimit nga ana e komunës, komuna lëshon pëlqim në afat më së largu 30 ditë dhënien e pëlqimit lëshohet edhe për vazhdimin e licencës.

Amendamenti 14, paragrafi 1, pika 1.14 duhet të fshihet kjo pikë pasi ligji ka rregulluar distancën për secilën segment para pikës 1.14 nuk ka nevojë që KPMM-ja me pas të ketë kompetenca mbi ligjin.

Neni 45, paragrafi 1 ndryshon si vijon. “Renta minerale të mbledhura nga KPMM-ja janë të hyra të përgjithshme të Republikës së Kosovës.

20% e vlerës së kësaj rente rialokohet në buxhetin qendror për buxhetin e komunës ku zhvillohen aktivitetet minerale i dedikuar në mënyrë specifike në zhvillim të komunave në fushën e mbrojtjes së mjedisit, infrastrukturës, sportit, shëndetësisë dhe arsimit.

Ne kemi nxjerr edhe përvoja të tjera gjatë hulumtimit në rajon, kemi marrë shembuj të ndryshëm.

Për shembull Mali i Zi e ka të rregulluar 30% sipas Ligjit për miniera kurse 70% e ka sipas tarifave aktuale që shkon në komuna.

Bullgaria pastaj e ka 50% me 50%, Kroacia 100% fikse edhe 30% pjesë e ndryshueshme. Sllovenia 50 me 50 në rast se dy komuna shfrytëzojnë ndahet në bazë të përqindjes. Shqipëria 25% do të thotë janë pjete që i alokohen komunave për zhvillim.

Dhe besoj që edhe në të ardhmen do të jenë pjesë përbërëse e komisioneve ose do të kontribuojnë në komisione me qëllim që ligji të jetë sa më funksional.

Pjesën tjetër ma merr mendja që do t'i sillim edhe të shkruara në bazë të kërkesave që do të jenë.

Po do të ishte mirë shumë që në Komision të ketë edhe njerëz nga Ministria e Financave edhe të Ambientit me që Financat kanë me pësua ndryshim edhe plotësim ndryshim tek Ligji për financat të Pushtetit Lokal. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, zoti Gashi!

Sa i përket pjesëmarrjes së Ministrisë së Ambientit ne kur e kemi bërë monitorimin e zbatimit të ligjit jemi konsultua me ta e kemi pas edhe në tryeza i kanë dhënë vërejtjet e veta dhe sugjerimet e veta për çka ligji momentalisht që është në fuqi më shumë e mbron ambientin se sa ligjet që janë të rregulluara nga ajo ministri.

Na ana tjetër taniemata veç janë rregullua, po dua me rikujtua se ne i kemi rregullua i kemi fut me ligj por problem është zbatimi sepse ne e kemi një ligj që i mbizotëron të gjitha ligjet tjera siç është Ligji për financat publike, por po dëshiroj me besua se përderisa i kemi të përfshirë këtë dispozitë ligjore nëpër tri ligje atëherë ndoshta do të jetë një farë presioni që me ndryshua Ligjin për qasje në financa publike në mënyrë që të jetë i zbatueshëm në dispozita për të cilën po flasim me përfitua komuniteti 20% të taniemës të minierave.

Dikush tjetër a e donë fjalën, Naser Peci, dekan i Fakultetit të Gjeoshkencës.

NASER PEÇI: Faleminderit, kryetare!

Të nderuar deputete, deputetë,

Kryetar komunash,

Përfaqësues të kompanive,

Shoqërisë civile,

Ne bot akademike apo Fakulteti i Gjeoshkencës në këtë rast konkretisht e shohim këtë ligj në kontekst të zhvillimit të sektorit të mineraleve në Kosovë që është shumë i rëndësishëm që lidhet edhe me punësimin e të diplomuarve edhe nga fakultetet tona në këtë rast zhvillimi i sektorit minerar apriori po i bie që është një zhvillim i fakultetit apo universitetit tonë që i kemi profilet që drejtpërdrejtë të lidhura me sektorin minerarë.

Në këto që u diskutua se për me qenë në një tryezë që po thuhet shumë është një përfaqësim i tillë në fakt po lidhem pak, se kanë qenë disa iniciativa në fillim që me u mbajt në lidhje me nismën për transparencë të industrisë .. ku do të formojnë një grup nacional shumë palësh të interesit ku është Qeveria, shoqëria civile edhe kompania që atëherë edhe janë obligime nëse Kosova anëtarësohet në një organizatë të tillë janë edhe raportimet e rregullta edhe rritja e transparencës në çdo aspekt ku Qeveria prioritet kryesor i ka përkushtimin për transparencë dhe luftim të korrupsionit, pastaj industria është ajo i zvogëlon rreziqet përmes .. investimeve kurse shoqëria civile rritë informacionin në sferën publike apo i jep shoqërisë civile mekanizmat janë ndihmës për ndërmarrjen e veprimeve.

Kurse sa i përket avancimit unë po e quaj të ligjit nga ligji aktual që është, ne u përqendruam në ato çka u cekën edhe në hyrje nga kryetarja nuk e di a u përmendën zonat e interesit po u kërkuan këto takime sidomos kompanitë janë këtu besoj që edhe këtu duhet të verifikojmë që krijimi i aplikimi i një vendi është përfaqësi, domethënë avancim i ligjit One Stop Shop.

Harmonizimi i ligjeve tjera sidomos ..ngjarje se këto takime që kanë qenë, ka qenë Ligji për pylltari që lejoj vetëm .. parë nuk e di tash se për sektorin minerar këta sektor gjithnjë konsiderohet që është një sipërfaqe e vogël për investime me afatgjate jetë më të gjatë.

Kurse gjërat e interesit avancimi këtu po besoj është shumë i qëlluar se këtu besa jam koncentrua pak që mundëson një zhvillim të sektorit minerar.

Hapësira apo mundësia e investimeve në zona të interesit dhe me një fjalë deblokimi i tyre apo .. sepse që nga viti 2008 janë zona, tash nuk e di ka mbërrë 11-në më duket numri besa atëherë edhe kam qenë pjesë e KPMM-së ende nuk ka ndonjë zhvillim sa i përket zonave të interesit.

Ja pse në ligj shkruan që nga momenti i shpalljes po konsideroj që hyrja e këtij ligji në fuqi i bie që edhe zonat aktuale që veç janë duhet të aplikojnë apo duhet të zbatojnë këtë afat për me mbajt atë kriterin e zonës me interes të veçantë.

E konsideroj që është avancim i ligjit të kaluar dhe me shpresë të zhvillimit të sektorit minerarë në Kosovë që gjithnjë e kam konsideruar një nga shtyllat e zhvillimit ekonomik të Kosovës.

Kuptohet se u përmend edhe nga deputetja edhe nga shoqëria civile me kontest të një zhvillimi të qëndrueshëm kompromisi të zhvillimit të sektorit minerarë është përmes zhvillimit të qëndrueshëm ku merren aspekti ekonomik social edhe mjedisor domosdo. Nuk është në rregull që duke e bërë një dëm mjedisor sidomos të ketë një zhvillim tjetër mirëpo me këto që është zgjidh edhe në botën botërore se zhvillimi nevojitet, i kemi resurset kështu që edhe ky zhvillim i qëndrueshëm edhe në aspektin mjedisor është i domosdoshëm. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, Naser!

Që e zbërtheve nga aspekti nga këndvështrimi shkencor rëndësinë e këtij ligji edhe zhvillimi qëndrueshëm edhe .. me heq atë raportin jo miqësorë ambient industri minerare.

Po, zonat e interesit nuk i përmenda po janë shumë të rëndësishme është e vërtetë se prej vitit 2008 janë të bllokuara ato zona dhe sigurisht në këtë tavolinë është dikush që kishte me fol edhe për këtë çështje sepse e di që duke e përcjell raportin e punës së Komisionit të Pavarur për Miniera me Minerale kam pa që ka pasur kërkesa për me i zhvillua to zona të interesit, mirëpo përderisa kanë qenë të bllokuara, të rregulluara me një dispozitë ligjore që fillimisht në atë kohë është mendua që do të zhvillohen më tutje po realiteti 10 vjeçar e ka pa që kanë qenë vetëm të bllokuara dhe ky ligj i adreson edhe ato probleme dhe mendoj që operatorët ata që janë industria minerale që është e interesuar me e zhvillua sektorin minerar do të ketë qasje në të gjitha resurset anë e këndë Kosovës sepse Kosova ka nevojë për një zhvillim ekonomik, zhvillim të qëndrueshëm siç e përmende.

Dikush tjetër a e donë fjalën? Prezantohu të lutem.

MUSTAFË BOROVCİ: Unë jam Mustafë Borovci, prej Shoqatës së prodhuesve të materialit ndërtimor prej argjile, përndryshe jemi si shoqatë e organizuar në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës.

Desha nja tri pika me i diskutua po paraprakisht desha me vu në pah që sa herë përmendet Ligji për KPMM-në menjëherë në opinion asocohet për aktivitetet e gurthyesve edhe të eksploatuesve të zhavorrit

Ne s'kemi të bëjmë as me njëren as me tjetrën, mirëpo i kemi shqetësimet tona si industri edhe besoj që pikat që u përmenden deri tash atakojnë aktivitetin e industrisë tonë siç është fjala për distancat ato e kufizojnë tej mase aktivitetin e eksploatimit të argjilës edhe disa probleme tjera.

Ju zonja deputete, edhe kur keni qenë në vizitë na ju kemi paraqitë këto shqetësime, i kemi dërgua edhe me shkrim po kisha dashtë që edhe prej deputeteve tjera me u kuptua që nuk është aktiviteti minerarë vetëm zhavorri edhe gurthyeset.

Përndryshe zonja deputete të dyjat e kanë pasur fatin sa kanë qenë ministre me marrë masa mbrojtëse për këtë industrinë tonë.

Mendoj që ajo që më së shumti e pengon aktivitetin në industrinë tonë është çështja e distancave për arsyen se ligji nuk i merr parasysh madhësinë e parcelave që janë të mundshme për mu përdorë në Kosovë.

Shumica e parcelave në Kosovë janë me madhësi 20-30 ari deri në gjysmë hektari e është rast shumë i rallë kur mundet me u gjet diku një parcelë që ka një hektar sipërfaqe.

Edhe sikur të kishte qenë pesë hektarë një parcelë kur futen në lojë krejt kufizimet që janë që i parasheh ligj atëherë përkundër që licenca mund të merret me afat deri 25 vjet aty nuk mund të ketë rezerva, nuk mund të ketë rezerva që të eksploatohet për atë periudhë 25 vjeçare.

Domethënë ne e paraqesim si shqetësim siç janë tash të parapara distancat, mendojmë që ato do të duheshin të paktën të jenë të përgjysmuara po ne këtu nuk e marrim përsipër punën e gurthyesve edhe të zhavorrit këto le të specifikohen edhe le të ndahen në vete nëpërmjet asaj që është minimi se te ne është.. që nuk kërkon minim edhe me këtë rast do të kish qenë më i mundur eksploatimi.

Një pikë tjetër që dua me potencua është neni 163 i ligjit i cili e përcakton shpronësimin e ndonjë parcele e cila mund të jetë në një zonë për të cilën ka hulumtime se gjendet mineral edhe që në këtë rast pala pasi që paraqet shkresë pranë KPMM-së e ka bërë përpjekje për me ra në marrëveshje për të drejtën e sipërfaqes ose për me e ble në rast se këtë nuk e arrin atëherë i drejtohet KPMM-së edhe KPMM-ja obligohet që me ju drejtua Qeverisë për shpronësim, këtë e përmban ligji mirëpo aty nuk ka afate edhe në rastin kur nuk ka afate ajo është e barabartë me zero.

Prandaj, ne kërkojmë që nëse është e mundur kjo të afatizohet që KPMM-ja t'i drejtohet për një afat për shembull për 6 muaj të qeverisë dhe Qeveria të ketë gjashtë muaj afat për me e bë shpronësimin e saj.

Një pikë tjetër që këtu i diskutua është çështja edhe e sigurimeve, për ne nuk e dimë a është apo mbetet edhe më tutje që sigurimet me qenë siç është tash në fuqi në banka apo do të jetë e mundur me u bë edhe me kompani të sigurimeve qysh ka qenë edhe më përpara.

Është edhe një shqetësim te puna e distancave edhe kur ka operim me një minierë ku është e licencuar ligji nuk të mbron edhe aty mund të ofrohet dikush dhe ta bëjë një ndërtim në pronë të veten po që është brenda atyre distancave edhe kur të vijë momenti për rilicencim prapë e humb kuptimin ajo se vjen dikush e ndërton një shtëpi është 250 metra distanca e ndërton dikush në tokë të vetë një shtëpi aty ofrohet 100 metra edhe ta nxjerr prej loje minierën për me u rilicencua për së dyti.

Mendoj që edhe kjo është dashtë me u pas parasysh edhe mundësisht mu përfshijë në ligj.

KRYETARJA: A keni diçka tjetër?

MUSTAFË BOROVI: Jo, faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, zoti Borovci! Kush e donë fjalën?

KEMAJL ZEQUI: Faleminderit!

Jam Kemajl Zeqiri, anëtar i Bordit në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale. Faleminderit!

Përshëndetje së pari për kryetaren e komisionit,

Deputetët, dhe

Të gjithë të pranishmit në këtë dëgjim publik për Ligjin për miniera dhe minerale.

Unë i dëgjova me vëmendje shqetësimet që u paraqiten do të thotë nga parafolësit, dua që të shkoj rend një nga një t'i shtjellojmë dhe nëse diçka mbetet, do të thotë sigurisht dikush do ta ngrit si çështje. U diskutua rreth zvogëlimit të distancave, për mbrojtje të mjedisit. Do të thotë, keni parasysh distanca në ligjin aktual është 150 metra, ndërsa në Ligjin për mbrojtjen e mjedisit është 100 metra. Do të thotë dhe 50 metra faktikisht është e pambuluar me ligjin aktual. KPMM-ja e ka të ndaluar të lëshojë licencë në një distancë me ligjin aktual deri në 150 metra nga lumi, andaj të gjitha këto faturime që i bëhen KPMM-së për degradim të mjedisit, nganjëherë e kemi përgjegjësi por nuk janë drejtpërdrejtë përgjegjësi e KPMM-së, për arsye se KPMM-ja nuk lëshon licenca në lumenj dhe na paraqet jashtëzakonisht na e shpenzon bukur shumë energji për luftimin e këtyre dukurive edhe pse nuk e kemi të përfshirë në legjislacionin aktual.

Domethënë, 50 metra ka mbet e pa përfshirë me ligj. Ata e kanë 100 m, ne e kemi 150 m. Do të thotë, krejt ajo çka kemi dashur me bë ne kemi thënë harmonizim me Ligjin e mbrojtjes së mjedisit për arsye se çdo kompani e cila edhe e merr licencën në KPMM duhet ta ketë pëlqimin nga Ministria e Mjedisit. Do të thotë edhe ajo është kompetencë e vetë Ministrisë së Mjedisit. U fol për garancionet bankare, largimi i garancioneve bankare. Draft ligji nuk e parasheh largimin e garancioneve bankare, kini parasysh në ligjin aktual thuhet që garancioni duhet të bëhet në ndonjë bankë që i ka tri A-ja e famshme, ndërsa ne jemi interesuar në BQK dhe në Kosovë nuk ka asnjë bankë të tillë të licencuar dhe praktikisht ne kemi mundur ta bllokojmë komplet sektorin minerar. Sepse, nuk ka një bankë të tillë dhe çka thotë garancioni bankar aktual, thotë që kompania duhet të bëjë garancionin bankar për krejt sipërfaqen e licencës dhe për tërë afatin e licencës dhe kini parasysh e kemi Ferro nikelin me një afat të licencës 25 vjet, po ashtu e kemi edhe KEK-un, të cilat kanë sipërfaqe jashtëzakonisht të mëdha përmbi 50 ose 60 hektarë dhe ju duhet të vënë paratë e tyre për 25 vjet deri në 1 milion euro në një bankë.

Do të thotë, ne çka kemi bërë në draft ligjin aktual kemi thënë që kompania do ta bëjë garancionin bankar në përputhje me planin e shfrytëzimit për aq sa e ka minierën, për aq sa e degradon minierën ka me mbajt garancion bankar, por jo për krejt zonën e licencës. Sepse, zona e licencës edhe zona operative e shfrytëzimit dallojnë dhe është e padrejtë që kompania të

obligohet me e mbajt në garancion bankar për tërë zonën e licencës kur nuk e prek atë zonë. Momentin që fillon atëherë në mënyrë parçiale e bën edhe krejt çka kemi dashur, kemi dashur me qenë konkurrues në rajon.

Maqedonia në tri vitet e para nuk lyp kurrfarë garancioni për rehabilitim. Do të thotë kjo ka qenë ideja dhe garancioni bankar nuk është heq, kjo të jetë e qartë. Te çështja e ... do të thotë ka qenë kërkesë edhe e mekanizmave ndërkombëtar, të cilët e përcjellin dhe e monitorojnë sektorin minerar. Një prej tyre ka qenë USAID-i, i cili e ka propozuar tri modele dhe çka kemi biseduar ne e kemi diskutuar që ne momentalisht nuk jemi të gatshëm modelin me e bë, modelin gjerman që e ceku edhe Dardani, që KPMM-ja do të thotë në KPMM ose dikur tjetër të gjitha licencat po me pëlqimet me u lëshua nga ato. Do të thotë, kemi shumë institucione, lëvizje të mëdha të institucioneve dhe kemi konstatuar që për momentin do të ishte varianti i tretë i propozuar do të thotë nga të gjithë bashkarish që KPMM-ja me shërbyer si agjent.

Sa i përket Dardanit pa dashur me, do të thotë çka me bë tash që kompanitë të shkojnë edhe presin me ka 4-5 muaj për një pëlqim qoftë në Agjencionin Pyjor të Kosovës apo diku tjetër. At shqetësimin është do të thotë i Dardanit, mirëpo unë me sa jam në dijeni mundem me gabu edhe Ligji i procedurës administrative i riu që është amendamentuar e parasheh që në qoftë se institucioni për 30 ditë nuk kthen përgjigje konsiderohet pozitive. Do të thotë, ajo domethënë e mbulon edhe do të thotë me sa e di unë është bërë ky plotësim ndryshim në Ligjin e procedurës administrative. Harmonizimi i distancave ose harmonizimi me ligjet e tjera, u cek këtu do të thotë ne japim licencën për 25 hektarë ndërsa Agjencioni Pyjor i Kosovës e jep për 5 hektarë pëlqimin.

Ju lutem, një pjesë janë edhe inxhinier edhe e kuptojnë ku do të zhvillohet një minierë me 5 hektarë. Nuk zhvillohet miniera në 5 hektarë, plus shtu distanca. Më vjen keq me e thënë po nuk ka ligj në botë që i përfshin distancat, sepse ato përcaktohen siç e ceku edhe kryetarja e Komisionit me analiza gjeoteknike i vetmi ligj sui generis jemi që kemi distanca në ligj, nuk ka ligj i minierave në botë që i përfshin distancat.

Zonat e interesit, me ligjin aktual nuk parashihet kohë e zhvillimit të tyre, ne si KPMM mbase me thënë edhe jemi “lodhë” nga kompanitë e huaja duke na pyetur kur do t’i zhvilloni, sot e dhjetë vite u bënë do të thotë pa u zhvilluar, ndërsa në draft ligjin aktual parashihet tri ose pesë vite me fillua me u zhvillua këto zona, nëse duam me e zhvillua si sektorë flas. Pastaj, mineralet energjetike janë procedura tejet të komplikuar nuk po hy për shkak të kohës me i shpjegua me ligjin aktual. Draft ligji aktual e parasheh zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, ku parashihet briketimi dhe ... i qymyrit. Ne kemi pas ndotjet pamë sa kemi problem me ndotje, një kimizim i qymyrit dhe një briketim nuk do ta kishim këtë ndotje. Prapëseprapë po përdoret ashtu i egër thëngjilli. Nuk bëhet do të thotë zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe kur të vjen briketimi natyrisht që ky do të kishte edhe ndotja do të ulej, ku do të hapnin edhe vende të mëdha të punës në pjesën ku veç po shfrytëzohet në mënyrë të paligjshme.

Po ashtu, ligji aktual nuk e parasheh dispozitë ligjore për hulumtimin e naftës dhe gazit dhe veç e dimë nga Kanadaja kemi jashtëzakonisht interesim për kompanitë për hulumtimin e naftës dhe gazit, ndërsa draft ligji aktual e parasheh do të thotë, hap rrugë edhe për hulumtimin e naftës dhe gazit. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, zoti Zeqiri! Kush e donë fjalën? Ai në fund atje, po. Nuk jemi në seancë, prezantohu ju lutem!

BASRI IBRAHIMI: Unë jam Basri Ibrahim, vij prej kompanisë "...". Jam një person që vij prej sektorit të prodhimit. Ju përshëndes të gjithëve, më vjen mirë domethënë që për herë të parë prezantohem me një debat publik ku diskutohet për ndryshim të ligjit, edhe pse ky debat domethënë na kemi qenë të informuar në një kohë shumë të shkurtë po besoj që do të japim vërejtjet përmes e-mailit.

Unë do të jem shumë i shkurt, nuk do i përsëris parafolësit e mi që folën. Jemi një kompani që merremi me hulumtim të mineraleve, s'kemi të bëjmë me zhavorr por po dua të shkoj direkt me zbatim.

Unë e përgëzoj KPMM-në për punën që e bën dhe jam shumë mirënjohës, sepse .. i ballafaquar me shumë sfida në Kosovë pasluftës ... sektorë të prodhimit. Një ndër institucionet më relevante, më i mirë për momentin deri tash është ... domethënë që nuk vonon dokumentacion, që kryen punën me kohë edhe me ndërgjegje më të pastër. Mua më intereson ... me përsërit licencën e ... shkaqe të mos funksionimit, domethënë të ligjeve në Kosovë është problemi të shfrytëzimi i tokës. Ju e dini për shembull që shumica e parcelave domethënë një pjesë e ka pylltaria, një pjesë e ka komuna, dhe një pjesë tjetër është sektorit privat, që në këtë ligj unë mendoj që duhet të fokusohemi shumë te parcelat e sektorit privat. Ne jemi kompania ... domethënë është e gatshme të fillojë me punë që sot, mirëpo pengesë është toka në shfrytëzim që e kanë ... edhe KPMM-ja që ka me qenë pëlqimi i ... marrë, ... parcela për me fillua me punë, me eksploatua xehen. Dhe, e dimë që është një sektorë që premtion zhvillimin ekonomik të Kosovës, flas shfrytëzimi ose eksploatimi i minierave.

Domethënë, pa e ... Qeverinë në këtë rast ne si ... private kështu i kemi sjell donatorët, i kemi donatorët i kemi kontratat vetëm pritët me fillua me punë. Mirëpo, pengesa është toka. Dhe ju kisha lut shembull që të shkurtohen dokumentet, kjo burokracia që është në fuqi në Kosovë që 20 vjet, ... shumë e shkurtë si domethënë Prishtinë me u kthye në Viti, se unë vij prej Vitisë, këtu që i keni pëlqimet mjedisore duhet me bë pëlqimin në urbanizëm, duhet me mbajt seanca, Kuvendi të shtyhet t'i merr pesë-gjashtë muaj për një pëlqim, këto nuk na konvenojnë fare hiq sepse investitori i huaj trembet, ikë kur i sheh këto pritje, këto burokraci, këto neglizhenca domethënë. U fol pak edhe për ndotjen e ambientit, e ne personalisht diku në Kosovë pasluftës e kemi ngrit ... fabrika të ujit edhe kemi mbrojt ambientin, duhet me e mbrojt ambientin sepse janë standardet

evropiane, flas gurthyesit, minierat, flas edhe për rastin e fundit që e patë Kosova edhe u pa që aty dolën shumë njerëz të famshëm, për shembull folën për ndotjen e ambientit që nuk janë të thirrur personalisht, unë mendoj që Kosova ka njerëz profesional edhe ka njerëz që me e zgjidh këtë problem edhe të ujit, edhe të ndotjes së ambientit, vetëm mungon vullneti domethënë për punë.

Kjo është në pika të shkurta. Faleminderit!

KRYETARJA:Faleminderit! Kush e donë fjalën? Jonuz Bulica!

JONUZ BULICA: Faleminderit! Përshëndetje e nderuara kryetare, Përshëndetje, jam Jonuz Bulica vij nga Kompania Sharr Cem. Ne kemi qenë shumë të interesuar që ky ligj të hyjë në fuqi sa më shpejtë edhe pse edhe ai ligji i vjetër kemi punuar me atë ligjin e vjetër aq sa kemi mundur edhe na ka shërbyer. Mirëpo, unë i pata pak disa vërejtje se unë nuk po e kuptoj diçka ose ky aplikimi për shembull “One Stop Shop” se ne vërejtjet tona i kemi dhënë kur na është kërkuar për këto ndryshim.

Neni 17 thotë për shembull, të gjitha aplikacionet ne i bëjmë në KPMM, mirëpo nëse del pak më poshtë te neni 31, pika 1. 5. Prapë kërkohet pëlqimi mjedisor. Domethënë kjo po bie ndesh me atë “one stop shop” se nëse one stop shop nëse e bëjmë një aplikim për shembull në KPMM ti prapë kur të shkosh te neni 31, për një aplikacion për shembull për licencë eksploatimi ty të nevojitet pëlqimi mjedisor. Do të thotë, “one stop shop” bie prej formës se ne prapë duhet me hy në dokumentacion, kur të shkosh te pëlqimi mjedisor aty kërkohet pëlqimi i Agjencionit të Pyjeve, aty kërkohet pëlqimi komunal do të thotë e njëjta procedurë mua sa po më duket ose ndoshta s’jam duke e kuptuar mirë.

Kjo është një vërejtje që ne prej fillimit kemi insistuar se nëse bëhet “one stop shop” do të ishte shumë e lehtë për neve, por nëse jetë në këtë formë sa po e kuptojë unë kjo nuk e ka rolin e “one stop shopit”. Edhe pata edhe një vërejtje tjetër, unë në ligj nuk po e shoh këtë sipërfaqen që ka qenë si brengë shumë e madhe të gjithë kompanive s’e di ku ke në ligj, për shembull sipërfaqja që duhet të jetë e barabartë me atë sipërfaqen në bazë të projektit zejtar, po a do të ketë, do të thotë në ligj a do të futet se nuk do të ketë pengesë nga Agjencioni i Pyjeve të Kosovës, këtu po them në ligj diçka nuk pashë një gjë të tillë.

Edhe fund e kam pas edhe vërejtjen herën e kaluar jam pak konfuz këtu te garancionet bankare për ri kultivim. Do të thotë, neve nuk na intereson se kur do të bëhen në bankë apo përmes letrave, por neve më shumë na intereson se thotë projekti të bëhet në koordinim me Agjencionin e Pyjeve të Kosovës me Ministrinë e Ambientit edhe me KPMM-në. Do të thotë ne kur ta marrim dikush kur ta mban atë projekt nëse ia japim ndonjë firme apo dikujt qysh do ta përpilon ajo, domethënë a me të trija këto me u marr vesh a duhet me e bë një projekt të ri kultivimit me

atë shumën e parave që janë aty dhe ku do ta dorëzojmë. E di ... nëse ka mundësi me u sqaru pak më mirë.

KRYETARJA: Faleminderit, Jonuz!

Besoj që këtu janë këta zyrtarët e KPMM-së që merren drejtpërdrejtë me zbatimin e ligjit dhe kemi qenë gjithmonë në konsultim me ta, i kemi analizuar vështirësitë që i kanë pasur edhe për këtë garancionin bankar që po flet ti besoj që ndonjëri prej tyre do t'i jap edhe përgjigjet, por dua me theksua diçka Sharr Cemi ndër ndotësit më të mëdhenj llogaritet në Kosovë.

Besoj që ndoshta ky ligj kishte me zbut pak qata, nuk lihet personale me ty Jonuz, por si industri po mendoj që do të pajtohet edhe kryetari i Komunës që është këtu, ka ankesa edhe prej qytetarëve atje që duhet me ia bë diqysh me e zbut pak me e rregullua.

JONUZ BULICA: Krejt në rregull është ne pajtohemi me ata por ne kemi vendos i kemi do standarde aty që monitorohen me siguri nga Ministria e Ambientit dhe janë ato që i mbajnë ato shënimet, por e di qysh po na ndodh neve nganjëherë. Edhe po duam me fitu edhe s'po duam me vra, e s'ka bash qashtu krejt. Ndoshta pas nja 20 viteve vjen, por bash në këtë moment është pak si vështirë.

KRYETARJA: Ne me ligj po mundohemi me afrua njëfarë balance siç e tha dekani zhvillim i qëndrueshëm që do t'i ketë parasysh çështjet sociale, zhvillimin ekonomik, edhe mbrojtjen e ambientit. Kush e donë fjalën? AzemRexha.

AZEM REXHA: Faleminderit, kryetare!

Ju përshëndes të gjithëve,

Deputetë të nderuar,

Kryetarë, të nderuar pranishëm.

Ndoshta kisha mundur me kontribu pak në lidhje me çështjen e garancioneve për rehabilitim dhe projekteve për rehabilitim që i përmendi edhe zoti Bulica.

Çështja e koordinimit mes KPMM-së, AKP-së dhe ... është pikërisht për me i zgjedh problemet mes kompanive, mos me ndodh sikur në të kaluarën që ju ka kërkuar një projekt të veçantë MMPE-ja, një ... dhe një KPMM-ja, realisht kanë kërkuar tri institucione me dorëzua projekte të ndryshme të rehabilitimit, ndërsa koordinimi këtu nënkupton që ne si tri institucione nxerrim rregullat, të cilat janë të harmonizuara dhe projektuesi juaj e dinë se çka duhet me përmbajt projekti. Besoj që kjo është një e arritur dhe në një formë e largon burokracinë domethënë që ka qenë më herët. Unë prej kompanive kisha prit do të thotë që do i keni edhe një çështje që unë paraprakisht kam harruar me e përmend si propozim çka ndodh me garancionet për rehabilitim tek zonat, të cilat kompania ka pas licencë mirëpo për shkak të shpalljes të zonave me interes të veçantë ose parqe kombëtare, ose ka qëlluar u nis një autostradë ose rrugë kush e bën edhe

kompania humb kriteret. Pastaj, kjo me ligjin aktual kompania humb kriteret për licencim, KPMM-ja detyrohet me ia pezullua licencën dhe pastaj kompania detyrohet me bë rehabilitimin e zonës ose ne ia konfiskojmë garancionin për rehabilitim.

Tash, unë mendoj që kjo ishte dashur një çështje me u përfshirë në këtë ligj, zonja kryetare që nëse institucionet e Republikës së Kosovës për shkak të shpalljes të zonave me interes të veçantë, parqeve nacionale, rrugëve e tjerë, ia pamundësojnë një biznesi, do të thotë ia shkatërrojnë në një formë biznesin atëherë përgjegjësinë për rehabilitim duhet ta bart institucioni i cili e ka shkaktuar do të thotë, ia ka humb kriteret e kualifikimit kompanisë së caktuar. Mendoj që kjo kishte me ndihmuar jashtëzakonisht shumë në një formë bizneset që ato mos me pas humbje. Po ashtu, ndoshta vlen edhe t'i shtohet një pikë tek çështja e pas konfiskimit të garancioneve, është mirë me e shkru që cili është institucioni përgjegjës i cili ka përgjegjësi me e kry rehabilitim pastaj, sepse ne me KPMM edhe këtë vit për shembull kemi konfiskuar garancionet për rehabilitim për kompanitë, të cilat kanë qenë të papërgjegjshme edhe e kanë ... zonën, mirëpo këto mjete shkojnë në buxhet edhe nuk është specifikua qartë që kush duhet me u marr me rehabilitim. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Për ata është edhe efekti pozitiv i organizimit të këtyre dëgjimeve publike, ne bashkarish kemi punuar edhe me juve si KPMM, por ... e nxit edhe idetë tjera me e pasurua më mirë ligjin. Po është shumë e vërtetë që përveç zonave të interesit që kanë mbet të bllokuara janë edhe parqet nacionale me ato zona të stërzgjeruara që mendoj unë, zona 1 dhe zona 2 qysh janë të parapara me ligj. Në këtë drejtim neve na jepet mundësia dhe rasti pas dëgjimit publik me e kontaktua edhe Ministrinë e Ambientit, njerëzit përkatës që merren me parqet nacionale dhe me pa mundësinë, sepse ne kemi resurset të cilat flenë dhe nuk mundemi me i zhvillua edhe do t'i shohim do t'i analizojmë mundësitë që mos të flejë ai resurs po të përkthehet në zhvillim ekonomik.

Domethënë, na pret shumë punë, ideja është shumë e mirë, por mos të harroj edhe diçka para se mia kalu fjalën dikujt tjetër kush te donë që gjithçka çka flitet këtu dhe çka mendoni që nuk keni arrit me e thënë këtu ju lutem i dërgoni me shkrim tek Administrata e Kuvendit, të gjithë ju që jeni të interesuar me e pasuruar ligjin ashtu nga këndvështrimi juaj pastaj grupi punues vendos dhe nganjëherë vota vendos me e përcaktua për demokraci ndoshta përfshihen, ndoshta edhe s'përfshihen por sidoqoftë neve na duhet si deputetë me i pas edhe opinionet e juaja dhe vërejtjet e juaja. Fjalën e ka kërkuar, drejtori i Divizionit për Prodhimin e Qymyrit në KEK, zoti Shefqet Baca.

SHEFQET BACA: Faleminderit, kryetare!

Përshëndetje për të gjithë, unë jam Shefqet Baca përfaqësues i KEK-ut për këtë takim. KEK-u kompani publike më e madhja që është aksionari i Qeverisë, faktikisht edhe problemet më të mëdha, të cilat i ka telashet faktikisht i ka me këtë ligj, i ka pas edhe i ka edhe problemet me të cilat ne ballafaqohemi rreth licencave për hulumtime dhe për eksploitim.

Ne si KEK muajin e dytë 2017, i kemi dhënë vërejtjet me shkrim fatbardhësisht shumica e këtyre vërejtjeve janë inkorporuar në këtë ligj, kanë mbet edhe disa të cilat unë shkurtimisht do t'i diskutoj këtu dhe të shikohet mundësia çka mundemi me bë për me lehtësua rreth marrjes së licencave dhe vazhdimit të eksploatimit, kryesisht ne si kompani që merremi me eksploatimin e qymyrit. Do të thotë të dallojmë KEK-unë, është KEK-u prodhimi i energjisë që s'ka të bëjë me këtë, edhe prodhimi i qymyrit. Do të thotë ne i nënshtrohemi licencave për hulumtime dhe për eksploatim.

Thashë janë shumica janë inkorporuar në këtë draft ligj që është për tu përshëndet, ne prapë kemi vërejtje rreth neni 14 që u diskutua shumë me të gjithë të pranishmit dhe kryetarja që e përmendi rreth distancave që ne e kemi më së shumti probleme për arsye se ne kemi sipërfaqen më të madhe me të cilën ne operojmë. Do të thotë, çdo minierë projektin ekzistues që e kemi ne është 5km e ka trolli jonë, 5 mijë hektarë ndërsa projekti që është në hartim e sipër i ka diku 7 deri 9 km katror, do të thotë janë 9 mijë hektarë me të cilët duhet me u ballafaqua 40 vjet e ardhshme për minierën në këtë minierë do të thotë, për objektet gjeneruese ekzistuese dhe objektet e reja që do të ndërtohen. Edhe ai afat i licencës për neve është i arsyeshëm do të thotë zgjatja prej 25 sa ka qenë 30 në 40 vjet pavarësisht se ambientalistët e kundërshtojnë këtë, por jetojmë në këtë fushë që Zoti na ka falë tash edhe ne duhet ta shfrytëzojmë aq sa kemi mundësi me e largua.

Do të thotë është çështja te neni 14, rreth distancave është dhënë prapë në Projektligj që distanca prej një objekti të... jo të një shtëpie, jo të një kolibe a një kaçak ne duhet me u ndal në 250 m, që kemi shumë probleme. Kjo e ka koston e vete do të thotë koston e shpronësimit, një sipërfaqe nëse e llogarit një perimetër miniera e ka diku thashë janë pesë km katrorë rreth e përreth minimumi aty i bjen një shtëpie me qenë ne duhet me e shpronësua 60 hektarë, ose duhet me i shpronësua për me e marr qata ose duhet me u reduktu në rastin konkret, rastin konkret për licencën që ne kemi aplikuar ne tash duhet me redukua mihjen për kaq distancë edhe ne i humbim diku në këtë projektin ekzistues si bëhet si në perëndim, janë diku 10.2 milionë ton qymyr që nuk munden me e eksploatu, ose duhet me i shpronësua qata 60 hektar ekstra, ose duhet me e reduktu qymyrin që kjo është një kosto që kushton.

Kështu që ne prapë po kërkojmë edhe me shkrim kemi kërkuar që distanca të rregullohet në bazë të asaj çka tha edhe më parë, do të thotë në bazë të llogarive që jep projekti se çdo projekt i llogarit gjeomekanikën e ka stabilitetin dhe i ka faktorët e sigurisë, do të thotë është 1.5 për objektet e banuara, 1.3 për objektet me rëndësi dhe 1.1 është distancë e rregullt që faktikisht projekti e jep ato duhet të përshtaten. Do të thotë është 10% e sigurisë nëse llogaritet, jo jo në metra, në përqindje është ajo. Do të thotë, nëse llogaritim është 10% e kalkulimeve sa del ka dal për shembull distanca, koeficienti... po edhe i shtohet këto koeficienti i sigurisë është një F një faktor që llogaritet në bazë të kohezionit, janë aty do formula do të thotë nëse është këndi 60 shkallë neve na del 60 shkallë faktikisht qitni 60 shkallë duhet me iu shtua edhe një 10% ose 50% nëse ka objekte dhe duhet me e marr një kënd për shembull ne e kemi ... 10 shkallë qashtu e

parasheh projekti 10 shkallë në atë 10 shkallësh janë të gjitha llogarit rrinë ai truall edhe nuk lëviz me një koeficient të sigurisë për objekte tash, 1.5, 1.3. 1.1 është e rregulluar edhe me një udhëzim administrativ.

Kështu që prapë ne mbesim në atë që kjo çështje të diskutohet, për arsyt se ne kjo e ka koston jashtëzakonisht të madhe të shpronësimit, do të thotë e tejkalon fusha. Rreth nenit 19, do të thotë licenca që i nënshtrohen një konkurrence këtu është dhënë që sipas projektligjit afati i shpalljes së zonave me interes të veçantë është 3 deri në 12 muaj. Ne i kemi dy vendime të Qeverisë që janë shpall në vitin 2004 dhe 2009, më duket, që është shpall diku 19 km katror zonë me interes të veçantë. Do të thotë e përfshin Sibovcin e madh komplet që me aprovimin e këtij ligji faktikisht kjo zonë bjen. Çka do të thotë kjo, për mua dhe për neve personalisht kjo 3 deri 12 është afat shumë i shkurtë për të aplikuar në një konkurrencë të tillë që vetëm për përgatitja e dokumentacionit edhe shpallja, t'i merr minimum 9 muaj rreth përzgjedhjes qasaj kompanie, po foli kompanie KEK-u për me aplikua në një zonë të tillë është problem. Një herë mu anulua ai tender faktikisht ti e kalon 12muajshin edhe nuk mundesh me tejkalue atë.

Një çështje tjetër që lidhet me këtë nen është për neve që unë ndoshta nuk e kam pas të qartë edhe ne e kemi diskutuar edhe me kolegët aty që kjo zonë, do të thotë nëse në moment që nuk është zonë me interes të veçantë ne e kemi një projekt që thashë e ka një sipërfaqe 7 km katror, është kjo sipërfaqe që projekti e ka paraparë 7 km katror as shteti, as Qeveria, as ne nuk kemi mundësi që përnjëherë ato se për me marr një licencë duhet me e pas duhet me qenë pronar i tokave ose pëlqimin me pas.

Nuk kemi mundësi as shteti me i marr me i shpronësua 7km katror, do të thotë 7 mijë hektarë është e paimagjinueshme, është projekti e jep fazat e shpronësimit do të thotë qito avancim vjetor. Sipas ligjit tash me hapjen e minierave të vogla dhe kompanive të vogla ekziston mundësia ne kemi raste edhe del dikush qitu i bën nja 5 hektarë i blen, prej vëllazërive e tjerë, edhe e merr një licencë në KPMM në këtë fushën që ne e kemi hartuar projektin dhe i mbaron dhe i bën nja dy miniera na vijne në qatë, qysh ndalohet kjo?

Domethënë nuk i kemi të qartë.... strategjia e minierave e parasheh qartë që zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme për kimizim të qymyrit mund të bëhet vetëm në pjesën Veriore të ,... do të thotë jashtë zonës së interesit të KEK-ut pa u dëmtua prodhimi dhe shfrytëzimi në kapacitete të larta. Domethënë nuk mundet me marr kurrkush licencë nga KPMM ose cilido institucion tjetër brenda zonës së KEK-ut, zonës e interesit....

Deri tash ka qenë zonë e interesit me këtë ligj kjo bjen, domethënë 3 deri 12 muaj nëse

Shiko, nuk vlen edhe te çështja vetëm një sqarim, te çështja e sqarimit nuk është thënë me u zhvillua për tre muaj po në fillim të procedurave mjafton një letër me u dërgua, një projekt me

thënë që ka me u hap edhe ajo konsiderohet që është në zhvillim e sipër. Ndërsa, sa i përket hapjes së atyre minierave të vogla nuk qëndron, do të thotë strategjia e minierave shtylla e parë e parasheh pjesën veriore të ...të Kosovës do të thotë që përfshin tash ju e dini edhe pjesën e Zhilivodës, ajo pjesa do të thotë që është krejt larg objektivit.

Neni 33, pika 2 ku parashihet që unë e përshëndes që është dhënë edhe nëse ne më së shumti KEK-u ka probleme me shpronësim, do të thotë me kornizë, me ligj edhe nuk po mundet me i tejkalua i dini edhe problemet i përmendi edhe kryetarja që i kemi pas edhe ende i kemi rreth shpronësimeve, rreth ndërtimeve ilegale.

Pajtohem me të nderuarin që tha që edhe ai të ketë një afat në momentin kur ne nuk kemi mundësi ose nuk paraqesim pengesa t'i drejtohem i KPMM-së me një shkresë që nëpërmjet ministrive përkatëse të bëjë shpronësimin e asaj zone po edhe kjo të ketë një afat, do të thotë jo në pakufi, por të ketë një afat të logjikshëm që neve që sigurisht që ne e kemi një strategji të avancimit të minierës dhe çdoherë e paraprijmë në 2 deri 3 vjet paraprakisht avancimit të minierës në mënyrë që të mos hasim në pengesa kjo e ka një efekt tjetër që duhet të rregullohet.

Gjithashtu, rreth rentave u fol shumë, renta nëse është dikush paguan rentë në këtë shtet, paguan KEK-u, që është tri euro për ton qymyri që kurrkund ndoshta unë nuk kam has në bazë të letrave që kam shtjelluar nuk e kam gjet kurrkund. Nuk është kompetencë e KPMM e lexova në ligj, do të thotë është kompetencë e Kuvendit, ministrive përkatëse, po gjithkund Shqipëria e ka 5%, Serbia 3%, të gjitha shtetet e botës e kanë diku 2-3% e prodhimit, ne e kemi 3 tonë, do të thotë ne i prodhojmë 8.5 milionë ton qymyr i paguajmë shtetit 25 milionë deri 26 milionë në vit. Është ngarkesë e madhe, 25-26 milionë, do të thotë 8 milionë prodhim i kemi rregullisht 3 euro në tonë po bëjnë 25 milionë. Kështu që kjo i kufizon investimet në sektorin e minierës. Andaj, edhe kjo duhet të diskutohet është temë me të cilën ne duhet të merremi.

Një çështje tjetër, ne rreth licencave që deri tash kemi aplikuar dhe jemi në aplikim e sipër faktikisht që licencat, të cilat është lehtësuar që Qeveria po lejon për zona me interes të veçantë ajo licencat po jepen dy vjet po këtu duke shikuar mundësinë, a ka mundësi kjo të realizohet 2+2, apo çdoherë ne duhet të aplikojmë prapë çdo 2 vjet, çdo 2 vjet. 2 vjet shumë shpejt po shkojnë për minierë është afat shumë i shkurtë, kështu që mundësia të jepet 2+2 minierave.

Edhe, kam ndoshta një vërejtje një sugjerim, unë i pash kryetarët e Komunave të Drenasit, Obiliqit nuk e pash kryetarin e Fushë Kosovës që vetëm sa për informim 50% e sipërfaqeve të KEK-ut gravitojnë në territorin e Fushë Kosovës. Mirë është që edhe Fushë Kosova të kyçet në këtë drejtim.

KRYETARJA: Ligji ka me vlej për të gjitha komunat e Kosovës pavarësisht cilat janë ato ...

SHEFQET BACA: Pavarësisht asaj, po ndoshta është mirë edhe ai të jetë i informuar krejt rreth kësaj çka po ndodh rreth KEK-ut. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Kush e donë fjalën? Dikush tjetër? Fjala është e juaja!

SKËNDER KRASNIQI: Unë jam Skënder Krasniqi nga Oda e Afarizmit të Kosovës. Po e shoh që më shumë ju institucionet jeni kah flisni ndërmjet vete se me ne, a në dëgjim publik na keni thirr.

Unë ju kisha ftuar që si komision ta vizitoni Odën e Afarizmit, ka qenë Komisioni i Pavarur për Miniera në mënyrë që të dëgjoni biznesin aty drejtpërdrejtë me problemet e mëdha dhe klimën e të bërit biznes. Realisht në atë që kemi vërejt në këtë sektor ka barriera shumë të të bërit biznes, barrierat janë te pengesat e ligjeve edhe ligjet që kanë kundërshtim njëra me tjetrën. Ta zëmë KPMM-ja jep licencë komuna ia revokon dhe krejt investimi shkon huq, ose ia revokon APK-ja. KPMM-ja jep ligj për 25 vjet leje, Agjencia Pyjore për pesë vjet. Domethënë, ka shpërputhje dhe është pengesë e madhe si dhe arsye pse në Kosovë nuk ka investime në sektorin më të rëndësishëm, që është në Kosovë. Nuk ka investime, as s'do të ketë investitor, sepse askush nuk vjen të investojë kur leja varet nga individi, ose leja jepet për pesë vjet dhe pas pesë vjetësh revokohet, është një pengesë e madhe. Pastaj, janë taksat të jashtëzakonshme. Ta zëmë, e keni taksën është vendosur që gjashtë-shtatë vjet nga agjencia pyjore e Kosovës 20 cent për metër katror, ose për pesë hektarë qira dhjetëmijë euro duhet t'i paguajë biznesi vetëm Agjencisë Pyjore, që është diçka që as dyqind euro për tokë bujqësore nuk merret qira, ndërsa kësaj i duhet dymijë euro t'i paguajë qira për gurë, ndërkohë që KPMM-së i paguhet taksa. Domethënë, është një vendim që dëmton shumë biznesin dhe është një arsye pse investitorë nuk do të ketë, as investime, përderisa këto ligje nuk harmonizohen.

Ne e përshëndesim këtë one stop shop, por besojmë që kjo të jetë funksionale për të gjitha të tri lejet, qoftë prej KPMM-së, Agjencisë Pyjore... meqenëse Agjencia Pyjore administron 42% të tokave pyjore të Kosovës, të sipërfaqes së Kosovës. Domethënë, është faktor shumë i rëndësishëm i saj.

Pengesë tjetër është mbrojtja e bizneseve. Nuk mbrohen bizneset në qoftë se jepet leja, ta zëmë një sipërfaqe të caktuar, u tha edhe më herët, ndërkohë dikush ose konkurrent, ose dikush bën një ndërtim brenda asaj sipërfaqe asaj nuk i vazhdohet për arsye se është bërë një ndërtim dhe thotë tash duhet me qenë 250 metra, ka qenë 500 metra është zvogëluar. Ne kërkojmë që kjo biznesi të mbrohet, të mos lejohet ndërtim. Në qoftë se, i është dhënë leja për atë sipërfaqe të mbrohet biznesi, sepse në moment që lejohet ndërtim atëherë krejt investimi që ka shkuar edhe leja, të gjitha bien poshtë, automatikisht. Dhe tash, për çka e kemi thirrur ne? Për çka u bë ai investim? Qysh u bë ai investimi?

Pengesë tjetër, që ka shumë e ne do t'ua dërgojmë edhe me shkrim, është taksë për rrikultivim të dyfishtë. Edhe Agjencia Pyjore merr taksë për rrikultivim, edhe Komisioni për Miniera merr taksë, për çka? Për sipërfaqe të njëjtë. Domethënë, ka pengesa aq të mëdha sa klima e të bërit biznes në Kosovë është jashtë çdo niveli dhe kjo është arsyeja pse nuk ka investime, as nuk do të ketë investime.

Duhet të ketë harmonizim të ligjeve. Ju jeni deputetë dhe merrni pjesë në të gjitha ligjet. Nuk duhet Ligji për miniera të jetë në kundërshtim me Ligjin për pyjet ose këto tjerat. Domethënë, të ketë harmonizim në qoftë se dëshirojmë të ecim përpara dhe vazhdim të mundësive që dikush të vijë të investojë në Kosovë. Është edhe ligji tash që e keni bërë, Ligjin me kushtëzim për korporata me 50% femra, që e ka bërë zonja deputete, që është realisht në kundërshtim të plotë me Ligjin për investime strategjike, që u bë pas 20 vjetësh, tashti korporata vjen dhe të detyron qysh me e menaxhuar kompaninë. Në Botë s'ka! Në Kosovë gjithçka ka!

Kështu që, ju njoftojmë si Odë e Afarizmit që të na vizitoni dhe të ballafaqoheni me realitetin e problemit të të bërit biznes dhe arsyet pse nuk ka investime në Kosovë, pse ka pengesa, pse jemi vendi më i pazhvilluar, me papunësinë më të madhe. Kemi 330 mijë të punësuar, ndërsa Maqedonia me popullatën e njëjtë i ka 750 mijë të punësuar dhe ne ua rrisim rrogat 80 mijë vetëve. Kujdesi në paga me i rritë shqetësohemi për 80 vetë që i kemi në administratë e nuk shqetësohemi për rininë, ku nga mosha 18 – 25 vjeçe 65%, sipas Entit të Statistikave janë të papunë. Me kë jemi ne?

Kaq! Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit!

Faleminderit shumë për këto vërejtje shumë të rëndësishme dhe këto sugjerime, po ne jemi munduar t'i adresojmë këto kolizionet ligjore me këtë ligj që po e bëjmë. Besoj që do të ju vizitojmë shumë shpejt si komision. E ceke një element shumë të rëndësishëm në këtë taksën e dyfishtë edhe të pyjeve edhe tantumën e këto. Besoj se duhet të merren shumë ngushtësisht me një analizë shumë të thuktë dhe Komisioni i Minierave dhe Mineraleve, që sinqerisht nuk e kam pasur idenë që ky është taksim i dyfishtë. Por, po e përsëris edhe një herë, për këtë gjë është i mirë dëgjimi publik.

Ne si deputetë kemi obligim ta mbikëqyrim zbatimin e ligjeve dhe unë kam kuptuar, pasi që i kemi hyrë analizës së këtij ligji për ta bërë një të ri, kam kuptuar se Agjencia e Pyjeve mbledh këtë farë takse bazuar në udhëzim administrativ, ndërkohë që ligji mbizotëron udhëzimet administrative dhe legjislacionin sekondar. Por, në mungesë të mbikëqyrjes dhe të tërheqjes së vërejtjes, ndoshta ka ndodhur edhe kjo. Besoj se në të ardhmen do ta rregullojmë edhe këtë problematikë dhe do të bëjmë kriteret ligjore, që të mos ketë kolizion të ligjeve, që të mos ketë kesi farë ambientesh të vështira të të bërit biznes në këtë drejtim.

Fjalën e ka kërkuar deputetja Mimoza, besoj se shumë shkurt.

MIMOZA KUSARI-LILA: Përshëndetje për të gjithë!

Unë s'e mora fjalën prej fillimit për arsye se jemi këtu për të ju dëgjuar dhe natyrisht për t'i marrë të gjitha komentet, të cilat adresohen sot në trajtim të draft-ligjit për miniera dhe minerale.

Dua të ju siguroj se secili koment dhe secili amendament i dorëzuar me shkrim do të trajtohet me seriozitet nga komisioni, siç është trajtuar, pa ngjyrimet politike, atë dua të ju siguroj dhe dua ta riafirmoj fjalën e kryetares në fillim, që me të vërtet interesat e përgjithshëm të zhvillimit ekonomik në të gjithë sektorët në Kosovë në këtë komision janë trajtuar, ndoshta mund të them, në mënyrën më neutrale të mundshme deri më tash. Prej përvojës së deritashme, duke i marrë parasysh të gjitha segmentet e jetës të politizuara në Kosovë.

Zoti Krasniqi e përmendi nenin dhe të gjithë ju që jeni përfaqësues të bizneseve, ose përfaqësoni shoqëri aksionare, është mirë t'ua sqaroni të gjitha bizneseve që janë shoqëri aksionare, jo SHPK, jo ndërmarrje të vogla, ose jo mikro-ndërmarrje, që kjo është në përputhshmëri të plotë me të gjitha direktivat evropiane dhe është e aplikueshme sot në një numër të konsiderueshëm të shteteve të Bashkimit Evropian, përfshi kështu direktivën prej vitit 2010, që Komisioni Evropian e ka përcaktuar si target për të ngritur pjesëmarrjen e grave si grupe të marginalizuara.

Domethënë, zoti Krasniqi, fjala "S'ndodh kurrkund në Botë!" është gjeneralizim i, të them, kështu... hajt se po them, për arsye se ndodh shumë afër nesh dhe nëse po flasim për standard, qoftë në aspektin mjedisor, qoftë në aspektin e përmirësimit të klimës së biznesit dhe e di shumë mirë për çka po flas, se kam qenë ministre e Tregtisë dhe Industrisë në kohën kur ka filluar të përmirësohet të të bërit biznes në Kosovë, domethënë prej vendit 129 e para në vendin 100, 99 edhe deri në fund kur tash është në vendin e 60-të.

Po ju them me përgjegjësi të plotë, që masë e tillë afirmative e barazisë në shoqëri është e aplikueshme në secilën shoqëri demokratike, gjithmonë nëse duam të jemi shoqëri demokratike me përfaqësim të të gjithëve. Përderisa, në asnjë moment nuk e kam dëgjuar në forma të organizuara të tilla kundërshtie të pjesëmarrjeve të pakicave, ku përbëjnë më pak se 10%, 6%, 7%, 8% në aspektin institucional, ndërsa ne në vazhdimësi mua më ka bërë përshtypje dhe më ka treguar, se në çfarë shoqërie mizogjene në fakt po jetojmë, kur është bërë një organizim aq i mirë i kundërshtisë së nenit që përfshinë vetëm shoqëritë aksionare.

Ne në grupin parlamentar, e dini, kemi në Parlament përgjithësisht ka përfaqësues të ndryshëm të bizneseve që janë zgjedhur deputetë, një prej tyre është edhe në Grupin Parlamentar të LDK-së, Ramiz Kelmendi, e pyeta pasi që u votua atë ditë, ai ka kundërshtuar përndryshe, por e ka të regjistruar biznesin e vet të madh si SHPK. Domethënë, atë nuk e prek ky ligj dhe është mirë të

sqarohet, se sot është kuptuar që në secilin dyqan, ose në secilën ndërmarrje të vogël tash duhet me i pas 40% gra, jo të punësuar, po flasim për pozita jo ekzekutive. Bordet, anëtarët e bordit janë pozita jo ekzekutive. Shërbejnë në bord dhe është mirë mos me krijua gjithë këtë panik, se tash duhet me ia nisë me gjet... përndryshe, vetëm një argument të thjesht dhe po e përmbyll këtu.

Në numrin e njëjtë të grave, ose vajzave dhe djemve që regjistrohen në universitet, në baza vjetore, 30% është numri më i madh i vajzave që diplomojnë në krahasim me djemtë. Për sukses po flas, me numër të njëjtë, domethënë në Universitetin Publik të Prishtinës i ke 4360 afërsisht vajza që diplomojnë, krahasuar me 3300 e diçka djem. Domethënë, 80% i ke pasive kërkesën për vajza dhe gra në vendet e punës, në raport me djemtë dhe burrat si punëkërkues. Do të thotë, apriori ndihen të diskriminuar vajzat dhe gratë nga tregu i punës. Nuk është... nëse konsiderohet ose vlerësohet që është por rezultatet e vendeve të Bashkimit Evropian që e kanë aplikuar flasin për të kundërtën, për ngritje të performancës së kompanive, shoqërive aksionare, prapë po e theksoj. Sa janë shoqëri aksionare te ju, ndoshta atë statistikë mund të na jepni e jo të na thoni, kurrkund në Botë nuk aplikohet. Aplikohet në Gjermani, aplikohet në Bullgari, aplikohet në Itali, aplikohet në Norvegji, aplikohet në të gjitha vendet dhe e ka një periudhë të aplikimit. Nuk e kemi edhe ne... plus nuk janë përcaktuar sanksionet me nen, sanksionet janë lënë prej Ministrisë së Tregtisë e Industrisë të përcaktohen konform elementit gradual të implementimit. Domethënë, nuk po themi ne që ua mbyllim kompaninë, nëse nuk e keni kuotën gjinore në bordet e shoqërive aksionare, por po themi që mbetet elementi i sanksionit në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

KRYETARJA: Faleminderit, deputete! Meqenëse, kanë mbetur që të sanksionohen me udhëzim administrativ ata që s'e zbatojnë ligjin, ndoshta ka qenë mirë me ua preferua edhe benefitet atyre që zbatojnë ligjin. Kështu që, bëhet njëfarë balance.

Fjala është për ju zoti Krasniqi. Shumë shkurt, se nuk e kemi temë sot...

SKËNDER KRASNIQI: Zonja deputete,

Unë desha veç të them, se bordet nuk janë ekzekutive por janë udhëheqëse të kompanive, ata udhëheqin dhe aty nuk duhet të imponohet, sepse ne po duam t'i thërrasim investimet e huaja. Duam t'i thërrasim dhe ato të gjitha kanë me ardhur si shoqëri aksionare dhe nuk duhet ne t'ua imponojmë në borde çfarë përfaqësimi të kenë, por duhet t'u imponohet çfarë vlere ka ai në borde në bazë të kësaj.

Ndërsa, sa u përket atyre jemi renditur, ne mund të renditemi edhe të parët, por për dhjetë vjet për 20 mijë vende është rritur punësimi në Kosovë. domethënë, ne mund të rregullohemi kur të duash me numra atje në ministri e në Bankë Botërore, po shih sa është rritur punësimi në Kosovë dhe çfarë punësimi kemi ne në krahasim me rajonin në popullatë. Një milion e dyqindmijë në

bazë të Entit të Statistikave janë njerëz të aftë për punë prej moshës 18 – 65. 330 000 i kemi të punësuar. Ky është fakt. Ky nuk është teori. Domethënë, të bëjmë ligje të aplikueshme, që e rrisin punësimin, e rrisin klimën e të bërit biznes, vijnë investitorët. Arsyeja pse s’po vijnë, të shohim pse s’po vijnë investitorët e huaj e jo veç të bëjmë ligje për të krijuar performancë.

KRYETARJA: Faleminderit, zoti Krasniqi! Unë besoj që përfshirja e grave, ose e gjinisë nëpër borde nuk paraqet ndonjë pengesë, ndoshta fillimisht kur njerëzit e keqkuptojnë, por deri tash s’ka pasur asnjë kriteri ligjor dhe nuk kemi mundur të ecim përpara dhe besoj se për bizneset është shumë më i dëmshëm disa pengesa joformale që dalin, që nuk janë të përshkruara fare me ligj, po udhës atje diku, për shkak të burokracive apo pengesave tjera, sot nuk e kemi temë gjininë. Kisha dashur t’ua jap fjalën atyre që s’e kanë marrë asnjëherë, por shumë shkurt. Dardan, të lutem shumë shkurt.

DARDAN ABAZI: Shumë shkurt.

Vetëm se kur nuk ma dhe fjalën në replikë, mendova se do të jetë diskutim pa replika dhe mund të merremi vesh ashtu, por është mirë të tregohet në fillim. Tash u tregua që ka replika preferenciale ka replika më pak të rëndësishme. Kështu që po ndihem pak i diskriminuar në këtë aspekt.

KRYETARJA: Dardan, ty të kemi të shtëpisë. Je çdoherë këtu, prandaj je pak më ndryshe.

DARDAN ABAZI: Faleminderit, e di. Por, nuk kam as replikë, është veç sqarim për Kemalin se edhe ashtu e kam të Vushtrisë vendës.

Te çështja e distancave që the se ekziston një ligj i mjedisit i cili është në kundërshtim të tij. Kur ka kolizion të ligjeve merret për bazë ligji që është më preferencial, plus që për këtë sektor Ligji për miniera e minerale është ligj dominues. Por, në qoftë se ka kundërshtime në mes ligjeve, merret ai ligj që përkon më tepër dhe preferon më tepër nevojën në terren. Në këtë rast kemi kërkuar që nevoja në terren thotë që nuk duhet të hiqet distanca nga lëmenjtë dhe për këtë kemi insistuar në të. Edhe kur ka nevojë në terren edhe ky ligj, për shembull, keni dalë kundër Ligjit për menaxhimin e financave publike, në pjesën e rentës, sepse është konsideruar që është e nevojshme.

Tha mirë kryetarja, që ekziston njëfarë lloj presioni me këtë ligj që të ndryshohet ligji i cili bie në kundërshtim me këtë. Për këtë ne kemi insistuar që të jetë distanca në mes të lumenjve në ligj. Vetëm këtë sqarim. Faleminderit shumë!

KRYETARJA: Faleminderit! Kush e do fjalën?

Trepça po më duket.

HYSEN VRAJOLLI: Unë jam Hysen Vrajolli-Treça. Përshëndetje për të gjithë!

Kam disa vërejtje shumë profesionale, ma merr mendja. Për të mos u zgjerua, së paku, ne nuk jemi një kompani juniore e cila duhet të marrë licencë çdo dy vjet. Përpara e kemi pasur mbi 20 vjet, sepse ne kurrë nuk po bëjmë diçka të re, i kemi trupat e hulumtuara dhe jemi duke zhvilluar aktivitetet shfrytëzues minerar me trupa që janë hulumtuar diku para 60 vjetësh.

Domethënë, kjo do të ishte që së paku pesë vjet mos të aplikojmë. Tamam po aplikojmë, po e marrim vone, se po na vonohen licencat. Bile, në vitin 2015 ne kemi pasur një mos aktivitet tre muajsh në aspektin e shfrytëzimit të eksplorimit për shkak të mungesës së licencës. E Trepça Kompani prej më të mëdhave botërore minerare me u ndal për licencë në Kosovë e tash shoqëri aksionare, nuk ma merr mendja që është aspak mire... ka qenë më tepër hajgare, e para.

E dyta, ne duhet ta kemi një gjë shumë të qartë, me shfrytëzimin dhe marrjen me aktivitet minerar, sidomos në shfrytëzimin e metaleve janë kompani që kanë buxhet qindra milionësh së paku, bile ekziston mundësia, kam parë shumë kompani që kanë harxhuar 100 milionë euro dhe rezultati i tyre ka qenë zero në hulumtime. Nuk ka pasur, hulumtim të keq nuk ka, por nuk ka pasur, për shembull, ka lyp dikush diamante e i ka shpenzuar 100 milionë, por për shembull Kanadaja, e kam parë një emision që i ka dhënë 95 milionë euro ia ka mundësuar veç kompanisë që ka bërë hulumtim dhe ka një vend të hulumtuar.

Ne jemi për kompani serioze për hulumtime, po ne e kemi një vërejtje se në licencat e Trepçës ku Trepça ka pasur licenca të hulumtimit dhe ka kryer hulumtime 50-vjeçare janë dhënë licenca të reja për hulumtim, edhe pse rezervat kanë qenë të verifikuara. Ju e dini të gjithë, s'po dua ta përmend atë rast. Ka shumë edhe raste tjera.

KRYETARJA: Jo, përmende. Përmende!

HYSEN VRAJOLLI: Shkurt, që kemi bërë 50 vjet hulumtime, 100 milionë euro i kadhën Trepça dhe kurrë nuk është bërë. Është bërë hulumtimi nga aktivitetet tona. Janë 24 hektarë që ne i kemi blerë me të holla, kemi punësuar njerëz, kemi bërë hulumtime 50 vjet. Është bërë verifikimi i rezervave afër 5 milionë tonë rezervat e ku ta di sa, dhe rezervat tjera të shfrytëzueshme dhe është dhënë një kompanie prapë në hulumtim, i cili ka bërë hulumtime nëpër vrima tona, ka marrë kampionë dhe është përvetësuar. Kemi, ju e dini fort mirë sa e kemi pas ngritur atë çështje. Kemi edhe raste tjera.

Jemi për hulumtime, ne nuk jemi si Trepçë me i mbajtur aty, se ne vetëm si miniera e Thanës që kemi pasur 400 km² zonë hulumtimi para '90-ës. Nuk jemi për t'i mbajtur ato zona krejt, se s'mund të zhvillojmë aktivitetet, por nëse vjen dikush e zhvillon aktivitet hulumtues dhe zhvillon aktivitet hulumtues përnjëmend, jo të vijë me një Golf-2 e me një çantë e të thotë "kam bërë hulumtime", t'i marrë hulumtimet dhe hartat tona, t'i marrë disa gjëra, "kam bërë selektime", ta blloktojë zonën dhe praktikisht thotë e kam bërë. Ne s'kemi hulumtim të mirëfilltë ende në

Kosovë për këto 19 vjet. Duhet me e kuptua se ata që kanë para në Kosovë është lehtë. Qysh është lehtë? Ne duhet ta përcaktojmë qartë kur fillon një aktivitet hulumtues dhe kur mbaron. Kur fillon aktiviteti hulumtues? Fillon prej kësaj date. Kur mbaron? Mbaron më rastin e përcaktimit të rezervave nga komisioni, i dërgon Komisioni i Pavarur rezervat, për shembull sa tonë ka zink, sa plumb, argjend, bakër, hekur, nikel, pa marrë parasysh çka, edhe e bën një projekt shfrytëzues. Në projekt shfrytëzues është aktiviteti hulumtues dhe është projekti i shfrytëzimit. Projekti i shfrytëzimit i ka standardet ndërkombëtare të rezervave. Ato rezerva që i bën me standarde ndërkombëtare, të jeni të bindur, janë para në bankë, që Banka Botërore menjëherë i jep paratë për të financuar për të bërë zhvillimin. Gjithkund në Botë kështu shkon.

Kompanitë pa asnjë para por me mend kanë marrë aktivitete kanë bërë. I kanë bërë këto, ka pasur farë parash, e ka bërë aktivitetin hulumtues mirë, i ka verifikuar rezervat, ka marrë para prej Bankës Botërore, e ka lënë hipotekë pronën e vet dhe ka zhvilluar aktivitetin minerar. Ato kompani janë sot milionëshe. Veç në këtë kuptim ne mundemi.

Po dalim tash te aspekti i ambientit, se ne si Trepçë jemi ndotës të mëdhenj historikisht, kemi faj. Jemi prej vitit 1929 është bërë ndotja e... qysh mund ne të ikim, ma merr mendja mua, ndotjes historike? Mund t'i ikim vetëm siç është në vendet e zhvilluara. Nëse ti e ke bërë një aktivitet hulumtues, ke marrë një leje të shfrytëzimit dhe fizibiliteti yt është 100 milionë euro përfitim. Për çdo ton mineral të shfrytëzuar ia qet rentën e ambientit, sepse asnjë kompani shfrytëzuese nuk është kompani e specializuar rehabilituese. Çelet një kompani rehabilituese, që rehabiliton ambientin në Kosovë. Atëherë, në bankë deponohen të gjithë aktivitetin e tij shfrytëzues, paratë prej rentës së çdo ton minerali, shpallet tenderi dhe kompania që është e licencuar për mbrojtje të ambientit e merr dhe mbron ambientin e nuk kemi kokëçarje, as ai prodhuesi, se të ndotësh ambientin jashtë mase është Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, Inspekcioni i Xehetarisë që nuk e lejon.

Po dalim tash në aspektin përfundimtar, te Bordi i Minierave dhe Inspektorati Minerar i minierave. Ne kemi shumë vërejtje, po të kallxoj, nuk po merrem me çështje të Bordit, çështje e Bordit zgjidhet qysh të zgjidhet, ju e dini. Por, aspektin e Inspektoratit, kallxom vend në Botë që ka inspektor praktikant. S'ka kund në Botë inspektor praktikant. Inspektori duhet të ketë dhjetë vjet përvojë pune dhe së paku dy miniera punë, që ai ta ketë, ta njohë krejt Kosova se kush është inspektori i minierave? Njeri profesional që i jep vërejtje, mua, këtij, atij, kompanisë, është i besueshëm dhe ka një background profesional. Jo të vijë inspektori e mos të dijë se çka është eksplozivi. Më vjen keq të them, po përpara na ka ndodhur.

Kur bëhen krejt këto në këtë frymë profesionale dhe shkencore dhe bëhet një rend dhe ligj, ne kemi probleme. Sa u përket lumenjve. Shiko, veç vullnet politik nuk ka që të ndahen lumenjtë, shumë lehtë është. Inspektorët janë përditë, Policia është, krejt janë, po shkoj unë po e marr një kamion zhavorr, në mundesha me e pru prej Drinit e pa më zënë dhjetë herë policia e me ma

marrë, qe. Po, nuk ia merr kompanisë që është e fuqishme, ajo po hyn aty po e merr, ky po e sheh, s'po guxon me i thënë inspektori "ndale punën". Po, s'guxon t'i thotë. Ai në komunë është e ka lidhjen, ai tjetri e ka lidhjen. Çka bëhet? Krejt tokën e Kosovës kanë me na e marrë lumenjtë! Shikoni çfarë degradimi është bërë.

Unë po të kallxoj të drejtën, se unë edhe privat kam qenë një prej projektuesve të shumë gurëthyesve dhe shumë lumenjve, veç është një problem, se ne kurrkund nuk guxon mbi një metër e gjysmë në lum të merret. Vetëm kah është shtrati i lumit një metër e gjysmë se kur vërshon lumi qatë hapësirë e mbush, po jo arën përreth. Shtrati s'guxon të preket. Mbrojtja e lumenjve anësor, domethënë këto janë ato aspektet.

Domethënë, nëse ka një vullnet komuna, KPMM-ja, ministria dhe Policia kjo ndalet për një ditë. Nëse s'ka vullnet, ligji në letër sa të duam mund të bëjmë ligje ne, kjo punë ka me vazhdua qysh është. me të vërtet, është tmerr të shohësh se çka janë bërë lumenjtë e Kosovës edhe në gurëthyes. Shumë gurëthyes përreth rrugës. Nuk mundet ekskavatori kah të shkosh nëpër të gjitha rrugët e Kosovës rreth rruge të marrësh zhavorr edhe thuajse askush nuk e di, atypari kalon inspekcioni, atypari kalojnë qeveritarët e po i shihni përreth. Domethënë, kjo çështje më tepër është e një vullneti politik, se është e një ligji, se edhe ligji i vjetër i ka mbrojtur këto, kurrgjë s'na ka penguar me i mbrojt lumenjtë.

Më falni pak, po... u mundova të jap një kontribut sado të vogël.

KRYETARJA: Faleminderit shumë, zoti Vrajolli!

Trepça është specifikë më vete. Urojmë që të fillojë të zbatohet ligji, të formohet ligji njëherë e më pastaj të merremi enkas me Trepçën edhe Kuvendi, KPMM-ja, Qeveria dhe të gjitha mekanizmat tjera.

Kemi mundësi ne t'i ndalim këto parregullsi, mirë e the, vullneti politik. Ne jemi munduar diçka përmes infrastrukturës ligjore që së paku të jetë në termat e referencës nëpër tenderë, që të kihen parasysh ato kompani që janë të licencuara, se kur po flasim për këto parregullsitë këto janë zakonisht operime ilegale, edhe përreth lumenjve, edhe gurëthyesve. Besoj që bashkërisht me një përpjekje të përbashkët të të gjitha institucioneve do të arrijmë ta zbusim këtë situatë.

Kush e do fjalën?

BASRI IBRAHIMI: Do të jem shumë i shkurtër.

Koleg i nderuar nga Trepça,

Me gjithë respektin,

Basri Ibrahimimi prej kompanisë Blerta.

Po ta them për shembull kompanitë private që janë në Kosovë nuk kanë bërë hulumtime serioze. Dhe pak na ke ofenduar... po po unë jam qaty bëj pjesë.

KRYETARJA: S'besoj që ke hy në aspektet e Trepçës, nuk po besoj. Edhe s'ke nevojë me ju përgjigj. Për Trepçën e pat fjalën dhe nëse nuk e ke fjalën për Trepçën...

BASRI IBRAHIMI: Ne jemi kompani private, ne i kemi krye të gjitha, me hulumtime, me analiza, me rezerva, me plan të shfrytëzimit, po pengesë është. E thash edhe më herët, e thash në vija të trasha. Pengesë është parcela, toka, është burokracia. Jemi duke pritur qe dy vjet për të ma dhënë tokën në shfrytëzim. Kjo është pengesa dhe këtu duhet me qenë syçelë delegatët e Parlamentit të Kosovës, duhet të jenë të prerë një herë e përgjithmonë, me marrë vendime të prera dhe të ekzekutueshme, jo me bë llafe shumë po me qenë i shkurt edhe punë më shumë.

KRYETARJA: Faleminderit! Dikush tjetër nëse do ta marrë fjalën, se sigurisht edhe ju jeni lodhur. Gati qe dy orë jemi këtu. Për neve... Urdhëro, prezantohu të lutem!

FATOS MEQA: Fatos Meqa prej Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Pajtohem shumë me zotin Vrajolli, pasi që përmendi përvojën në vitin 2015, një pauzë katër muajshe a pesëmuajshe e licencës së operimit të Trepçës. S'di a është rregulluar kjo me ligj, në rast të mosfunksionimit të Bordit të drejtorëve a do të përsëritet ky rast në të ardhmen.

E pash ligjin dhe pash se që nga fillimi përmenden standardet e vlerësimit, standardet ndërkombëtare të vlerësimit që do të jenë të aplikueshme në bazë të këtij ligji, por nuk e pash se cilat janë standardet. Standardet janë disa. Ky ligj, pra nuk i ka përcaktuar. Do të ishte mirë të përcaktohen standardet, a janë standarde kanadeze, a janë australiane, a të tjerë... i dinë ekspertët e fushës. Duhet të përcaktohen. Këtë po e përmend, sepse ne duhet t'i përgatisim kuadrot. Jam shumë i sigurt, se as në ministri, as në agjencitë e pavarura, as në ndërmarrjet publike apo shoqërore, nuk kemi njerëz të licencuar për këtë vlerësim dhe do të ishte mirë, që të dërgojmë njerëz që të përgatisim në këtë fushë, që t'i hyjmë një ligji me standarde ndërkombëtare, ndërkohë që do të kemi njerëz të specializuar për ato standarde.

Desha të pyes a janë paraparë mekanizmat e kontrollit në instancat e ankesës, në këtë rast, për shembull, në rast të gjykimit jo të drejtë, që mund të ndodh për shkak të mos përvojës, për shkak të paditurisë, keqmenaxhimit, keqpërdorimit, e tjerë. Cilat janë? Nuk pash në ligj që ka instanca të ankesës. Cilat janë mekanizmat e kontrollit, e tjerë... mos ta zgjasim. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Kush e do fjalën? Kryetari i komunës së Hanit të Elezit, zoti Suma.

RUFKI SUMA: Përshëndetje për të gjithë.

Unë s'do të ju marr shumë kohë, veç desha një sqarim më shumë. Edhe unë edhe kryetari i Obiliqit, ka prezantuar qëndrimet e asociacionit të komunave të Kosovës. qëndrimet e komunës që u përmend pse nuk merr pjesë Obiliqi, ose pse nuk futet, po këtu nën një mund të asociacionet e komunave të Kosovës ka vërejt ose propozime që i bën. Edhe bile e përmendi kryetari harroj me e përmend te neni 4, te përkufizimi termi komunë nuk figuron kurrkund. Kemi kërkuar që të shtohet termi "komunë", për shkak se domethënë përmendet ndoshta brenda ligjit komuna në disa vende po si term nuk është dhe te të hyrat kur u përmend te renta 20% është kërkuar që kjo e hyrë të jetë si e hyrë vetanake, jo si grand qeveritar, për shkak se nëse është grand zakonisht komuna nuk mund ta shfrytëzojë, gjithmonë i merret ajo dhe nuk mund ta shfrytëzojë.

Në atë ku u përmend 20% nga rentat t'i mbetet komunës, kjo rentë mbetet si e hyrë vetanake, se e harroi kryetari ta përmend. Faleminderit!

KRYETARJA: E do fjalën dikush?

MUSTAFË BOROVI: Shumë i shkurtër do të jem.

Unë e kam një pyetje, nëse ka mundësi, një sqarim te puna e distancave prej zotërinjve që kanë marrë pjesë në draftim të ligjit, në diskrecion të kujt mbetet sipas draftligjit përcaktimi i distancave. A po e përcakton vet kompania projektuese në bazë të kriterëve teknike apo mbetet në diskrecion të ekzekutivit të KPMM-së, që atë projekt me kriteret teknike me... meqenëse në draft nuk do të figurojnë distancat fikse, siç ka qenë në ligj deri tash.

KRYETARJA: Faleminderit! Do t'i kemi parasysh gjatë punës gjatë amendamentimit në grupin punues. Edhe një herë kërkoj nga ju që t'i dorëzoni me shkrim te administrata që mbështet komisionin. Nëse s'ka dikush të shtojë diçka... Po, urdhëro! Deputetja Hykmete Bajrami.

HYKMETE BAJRAMI: Unë mendoj se distancat do i kthejmë në ligj, po ndoshta do të jetë mirë të punojmë edhe më tutje, në mënyrë që t'i përcaktojmë ato për eksploatim të zhavorrit dhe distanca prej lumenjve. T'i bëjmë distancat e gurëthyesve prej vendbanimeve. Sot ka gurëthyes që janë shumë afër shtëpive të banimit dhe është me të vërtetë i padurueshëm pluhuri dhe është vdekjeprurës, e dini ju, në shumë vendbanime. Gjithashtu, duhet të përcaktohet pjesa e sektorit të mineraleve.

Më pëlqeu shumë propozimi, kjo taksa e rehabilitimit, që të bëhet nga dikush tjetër dhe jo nga kompania. Para së gjithash, kemi raste kur kompania private bën projekte glamuroze dhe asnjëherë nuk e implementon, në fund ta bjen një raport që assesi, as nuk ke mekanizma për ta përcjellë se si e ka implementuar atë projekt të rehabilitimit dhe nuk dihet se si e ka kryer.

Po ju njoftoj, që Ligji për pyjet është i gatshëm që nga qeverisja e kaluar komplet dhe e ka harmonizuar këtë dispozitën që është në kundërshtim me Ligjin për miniera dhe minerale, pesë

vjet me njëzetepesë vjet, domethënë ka shkuar në njëzetepesë vjet. Këtë e kemi bërë në bashkëpunim me komunitetin e biznesit në atë kohë, ka qenë vetëm një kosto buxhetore lidhur me rojet e pyjeve, e cila nuk është përballuar në atë kohë dhe për këtë arsye nuk ka kaluar. Por, besoj se është krijuar hapësirë dhe besoj se Ministria e Bujqësisë e bjen shumë shpejt.

Edhe një informacion tjetër që desha t'ua jap, është që garancia bankare, ku flitet për bankare ne do e fusim ato që janë të vlefshëm njëtrajtshëm dhe garancitë që lëshohen prej kompanive të sigurimit, sepse një gjë të tillë e ka pranuar Banka Qendrore e Kosovës në momentin kur garancia bankare dhe garancia domethënë ato i ekzekutojnë. Tash e kemi parasysh Banka Qendrore mban depozitat që janë kusht për kompaninë e sigurimit, ajo ndihmon në ekzekutimin e tyre. Krejt çka duhet është me pas siguri në ekzekutim dhe Banka Qendrore e Kosovës ofron këtë siguri. Atëherë, këto garanci që kërkohen do të jepen si të tilla, po besoj që të njëjtën gjë mund ta bëjmë edhe rreth taksimit të dyfishtë. Ne mund të fusim dispozita dhe të fillohen bisedimet me Ministrinë e Ambientit, për shkak se edhe pse taksa është e rregulluar atje me udhëzim administrativ, prapë Ligji për miniera dhe minerale nuk mbizotëron mbi udhëzimet administrative të një ligji tjetër, të një udhëzimi administrativ që derivon prej komplet një ligji tjetër, por meqenëse është udhëzim administrativ ne mund të gjejmë mirëkuptim me Ministrinë e Bujqësisë, që ata ta ndryshojnë udhëzimin administrativ. Ju e dini që procedura për plotësim ndryshimit e udhëzimit administrativ është shumë më e thjeshtë, se sa për ligj. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, deputete!

Nga ky dëgjim publik, besoj se të gjitha palët do të ndahemi të kënaqur. Sigurisht, se mesazhet janë të qarta për institucionet që zbatojnë ligjin. Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale duhet të ketë kujdes në shqetësimin që e tha Trepça, që të mos i jep, po edhe ndonjë tjetër ndoshta që s'ka arritur ta thotë, që të mos lëshojë, jam e bindur që nuk e bën një gjë të tillë, me lëshua licenca në ato hapësira ku është e paqartë pronësia dhe ku ka pretendentë që janë dy-tri subjekte apo individë pronarë të atyre tokave, siç ishte rasti me Trepçën që e përmendi apo edhe ndonjë rast tjetër.

Të lutem, shumë shkurt, me juve të Ministrisë së Zhvillimit bisedojmë në grupin punues. Selvete, shumë shkurt.

SELVETE GRAJÇEVCI-PLLANA: Jam përfaqësuese e Departamentit ligjor të KPMM-së.

Desha pak sqarime lidhur me garancitë bankare.

Fillimisht, ne kemi filluar me kompanitë e sigurimeve, kemi kërkuar garancitë bankare nga kompania e sigurimeve, me i deponuar mjetet, qysh KPMM-ja i ka paraparë, për të bërë rehabilitimin. Mirëpo, çka ka ndodhur? Më vonë kur ne kemi filluar me plotësimin e ligjit i kemi kërkuar garancitë bankare, jo nga kompania e sigurimeve, por nga bankat. Tash, kur ka ardhur koha ju ka skaduar afati i licencave të shfrytëzimit, mjetet që janë ndarë nga kompanitë e sigurimeve ne kemi bërë kërkesat që kompania e sigurimeve ato mjete që i ka deponuar për

rehabilitim t'ia kthejë KPMM-së për ta kryer qëllimin për të cilat janë ndalur. Edhe asnjëra nga kompanitë e sigurimeve deri sot nuk na ka ofruar këto mjete, as nuk na ka kthyer përgjigje lidhur me këto çështje që ne kemi kërkuar të bëhet rehabilitimi për mjetet e ndalura.

Kemi pasur raste, kur nga bankat janë ndalë, nga bankat janë deponuar mjetet dhe janë kthyer në buxhet të KPMM-së, ruhen për të bërë rehabilitimin. Prandaj desha disa sqarime, arsyeja pse ne kërkojmë nga bankat? Unë do të kërkoja prapë që rehabilitimi të rrinë mjetet në banka.

HYKMETE BAJRAMI: Kryetare, a bën veç t'i jap sqarimin?

KRYETARJA: Faleminderit! Urdhëro, deputete.

HYKMETE BAJRAMI: Garancia, qoftë e lëshuar nga banka, qoftë nga ndonjë kompani e sigurimit, sipas Ministrisë së Financave e ka peshën e njëjtë dhe ju thash se depozitat e kompanive të sigurimit qëndrojnë në Bankën Qendrore të Kosovës. Banka Qendrore është garant për ekzekutimin e tyre, por duhet ta dini që janë disa hapa për ekzekutim të garancisë bankare. E para, çdo garanci, qoftë bankare, qoftë nga kompania e sigurimit, ka një afat kohor. E dyta, ju keni një farë lloj kontrate, domethënë në këtë rast në atë që ka marrë licencën, qoftë për eksplorim, qoftë për eksploatim. Në qoftë se, ai nuk e ka kryer rehabilitimin, ose si e keni ju, atëherë ju kërkon ekzekutimin e garancisë. Unë po ju tregoj, që në rastin e Brezovicës ne kemi ekzekutuar, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë e ka ekzekutuar garancinë prej gjysmë milioni euro dhe ato para kanë shkuar në Buxhetin e Kosovës, domethënë nuk ka pasur asnjë lloj problemi rreth kësaj. Ka qenë e kompanisë së sigurimit. Tash...

SELVETE GRAJÇEVCI-PLLANA: Kam qenë vet në Bankën Qendrore...

HYKMETE BAJRAMI: Atëherë, Banka Qendrore është përgjegjëse nëse ju i keni respektuar afatet, ata duhet prej depozitave t'ua japin të hollat. Domethënë, duhet të filloni procese gjyqësore.

SELVETE GRAJÇEVCI-PLLANA: Ata kanë thënë që nuk ...

KRYETARJA: Faleminderit! Jemi në fund të këtij dëgjimi publik. Unë pash në bazë të regjistrimit që e kam këtu, se ka edhe kompani të huaja, përfaqësues të kompanive të huaja të operimeve minerare. Ndoshta i kanë marrë përgjigjet, sepse s'e kërkuan fjalën. Ndoshta, po shpresoj që do t'i dorëzojnë vërejtjet dhe sugjerimet e tyre me shkrim. Edhe një herë po kërkoj që çfarëdo që të jepni vërejtje referojuni nenit, dispozitës ligjore, jepni arsyeshmërinë, pse duhet të jetë kështu, pse duhet të ndryshohet.

Faleminderit shumë për pjesëmarrje! Ministria e Zhvillimit, shihemi në grupe punuese.

Faleminderit shumë!

Afati i dorëzimit të materialeve shtesë të jetë deri të hënën.